



Fehd ibën Jahja el-Amari

Dispozitat e Udhëtarit

eSsebil

Titulli i origjinalit

زاد المسافر

تأليف

فهد بن يحيى العماري

القاضي بمكة الاستئناف بمكة المكرمة

Dispozitat e udhëtarit

Fehd ibn Jahja el-Amari

(Gjykatës pranë gjykatës së Apelit në Mekë)

Përktheu:

Sefedin MEHANI

Arsim GASHI

Redaktor fetar

Mr. Xheladin LEKA

Redaktor letrar:

Mr. Arjan KOÇI

Botues:

ESSEBIL

Gjilan, 2018

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara: asnjë pjesë e këtij publikimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem, të transmetohet në ndonjë formë, kuptim, në mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjim, përkthim apo shkrim pa lejen e botuesit.

Fehd ibën Jahja el-Amari

Dispozitat e udhëtarit

Parathënie

Çdo lavdërim i përket vetëm Allahut të Madhëruar. Paqja, bekimet dhe mëshira e Allahut qofshin për atë pas të cilit nuk ka më Profet tjetër.

Më të vërtetë njeriu, nga natyra e tij, dëshiron të lëvizë prej një vendi në tjetrin, të ndryshojë nga një gjendje në tjetrën, saqë te shumë njerëz kjo është bërë mënyrë argëtimi dhe dëfrimi. Për këtë arsye, ka njerëz që çdo muaj vizitojnë një shtet, apo i kalojnë stinët e vitit në vende të ndryshme. Udhëtojnë për të kryer adhurime madhështore, si p.sh.: për kryerjen e haxhit, për kërkimin e diturisë, për thirrjen në rrugën e Allahut të Madhëruar, apo dhe në kërkim të mjeteve të jetesës, për tregti, peshkim apo dhe arsye të tjera. Prandaj të gjithë duhet t'i njohin dispozitat e fesë, kudo të gjenden, në udhëtimet apo vendbanimet e tyre. Këto njohuri fetare duhen marrë nga njerëz të dijes, të besueshëm e të përgjegjshëm, të cilët njihen për besimin e pastër, për idetë e drejta dhe metodo-

logjinë e saktë. Kjo dituri është fe, prandaj bëni kujdes prej nga e merrni fenë tuaj, në veçanti në këtë kohë kur janë shtuar problemet doktrimore dhe metodologjike; në një kohë kur *fetvanë* (opinionet islame të dijetarëve për çështje të caktuara) nuk e kursen askush (të gjithë mund të japin *fetva*). Për pasojë, i futën njerëzit në dyshime dhe shkaktuan huti tek ata.

Feja është gjëja më e rëndësishme që ka muslimani në këtë jetë. Feja është thesari më i vyer dhe projekti më madhështor që ka muslimani, nga koha kur arrin moshën e pubertetit, derisa takon Allahun e Lartësuar.

Feja është shpëtim, humbja e saj do të thotë dëshpërim. Muslimani ka frikë nga çdo gjë që mund t'ia asgjësojë apo t'ia dobësojë fenë, ashtu sikurse tregtari ka frikë se mos e humbasë pasurinë. Njeriu duhet të bëjë kujdes, të mos ndjekë e

pasojë opinionet e dobëta pa referenca dhe lehtësimet e pabazuara¹.

O udhëtarë, dituria, përmendja e Allahut dhe studimi i Librit të Tij janë pajisja më e mirë në rrugën drejt Tij. Ju përshëndes duke lutur Allahun që të më ndriçojë rrugën drejt zemrave tuaja dhe të më dhurojë çelësat për hapjen e tyre. Ah, sa e mirë është kjo melodi!² Dhe sa i mirë dhe i lezetshëm është ky udhëtim!

Gjëja më e mirë që muslimani mund t'i dhurojë vëllait të tij është fjala e urtë, nëpërmjet së cilës Allahu i shton devotshmërinë apo e pengon nga ligësia.

¹ Shumë njerëz nuk bëjnë dallim mes dijetarit, kërkuesit të dijes, thirrësit, këshilluesit, imamit të xhamisë, muezinit, lexuesit të Kur'anit, gazetarit të programeve fetare, nxënësit në fakultetin e shariatit, konsulentit social, poetit musliman etj. Të gjithë këta i vendosin në të njëjtën gradë njerëzit e dijes, të *fetvave* (verdiktet fetar) dhe udhëheqësit e ymetit islam.

² Tek arabët e hershëm ishte zakon që gjatë udhëtimeve, ai që kishte zë të ëmbël dhe melodik të këndonte diçka nga poezitë e tyre. (shën.përkth.)

O *udhëtarë*, në vijim po ju prezantoj këtë përmbledhje të librit tim: *“Përmbledhja e rregullave të udhëtimit”*, botimi i shtatë, duke iu përgjigjur kërkesës së disa vëllezërve, për të qenë ky libër ndihmëtar dhe shoqërues për udhëtarin. Është një libër jo i rëndë në peshë, i lehtë për t’u përvetësuar, udhëzues për fillestarët, me gjuhë të kursyer, i lehtë për t’u mbartur dhe për t’iu referuar çështjeve që ai trajton. Jam përpjekur që në këtë libër të sjell atë çfarë dëshiron udhëtari dhe çfarë i intereson atij, duke u përqendruar në çështjet më të rëndësishme të udhëtimit. Libri përmban 250 çështje, është i zhveshur nga çështjet dytësore dhe ato me natyrë polemizuese, sikurse nuk kam përmendur argumentet përveç se në disa raste të rralla. Referenca e librit gjendet në librat e haditheve profetike dhe komentet e tyre, në opinionet e sahabëve, të tabiinëve, dhe të katër imamëve të mëdhenj: Ebu Hanife, Malik, Shafi, Ahmed dhe ndjekësit e tyre dhe të tjerë udhëheqës të Islamit e pishtarë të rrugës së drejtë, Allahu i mëshiroftë dhe i

shpërbleftë me të mira për gjithçka që kanë bërë për Islamin dhe muslimanët!

Kam zgjedhur atë çfarë mendoj se është provë dhe arsyetim i shëndetshëm tek dijetarët të cilët kanë për referencë Fjalën e Allahut dhe Traditën e të Dërguarit të Tij. Allahu i Lartësuar thotë:

فَإِنْ تَنَزَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ

“Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit.”³

Kush dëshiron të shohë diskutimet dhe argumentet mbi çështjet e udhëtimit le t’i referohet librit origjinal dhe librave të tjerë të kësaj fushe.

E lus Allahun që ta bëjë këtë libër të dobishëm dhe ta pranojë atë ashtu si është më mirë, ta bëjë punën time të sinqertë, të bekuar e të dobishëm përgjatë viteve dhe me kalimin e kohës, ta ruajë shpërblimin për të në Ditën e Gjykimit, ta shkruajë si vepër të mirë që do të më shpërbejë pas vdekjes. Ai është Dhuruesi më i mirë dhe më Buj-

³ Kurani, Nisa: 59.

ari në mirësinë e të Cilit shpresohet! E titullova *“Dispozitat e udhëtarit”*. Ia lejoj çdokujt që dëshiron ta botojë, ta përkthejë e ta shpërndajë, me dëshirën e mirë që ajo të jetë sadaka (shpërblim) për prindërit e mi dhe për familjen time.

Dobitë e udhëtimit

- Udhëtimi është mundësi mendimi rreth krijesave të Allahut në univers.
- Udhëtimi është mundësi meditimi e vetëdijesimi, mundësi për të marrë veten në llogari dhe t’u përgatitur për realizimin e projekteve dhe objektivave në jetën tonë.
- Udhëtimi është mundësi meditimi për udhëtimin në botën tjetër. Jemi duke ecur nga një vendbanim në tjetrin derisa të arrijmë në botën e përhershme: në Xhennet ose Zjarr, Allahu na ruajtët nga zjarri i Xhehenemit!
- Udhëtimi është adhurim, por dhe argëtim, një mundësi për forcimin e lidhjeve fafëfisnore dhe shtimin e vëllezërve.

- Udhëtimi është mundësi për t'u njohur me vendet e botës, me kulturën, qytetërimin e dijetarët e këtyre vendeve.
- Vizita e vendeve të shenjta: në Qabenë e Shenjtë dhe në Xhaminë e Pejgamberit është një udhëtim shpirtëror besimi, një mundësi vetedukimi.
- Udhëtimi e stërvit zemrën dhe trupit i sjell kënaqësi, këtë këshillë kanë mjekët, veçanërisht të rënduarit shpirtërisht të lodhurit nga brengat dhe mërzitë. Udhëtimi është ilaç kurues, i dobishëm për të sëmurët shpirtërorë dhe psikikë.
- Udhëtimi zbulon të fshehtat e shpirtit të njeriut në aspektin e sjelljes e të moralit, në raportet me Allahun dhe me njerëzit.

Dispozitat e udhëtimit

Parametrat dhe kriteret që duhet të plotësohen në një udhëtim, në mënyrë që të lejohen lehtësimet fetare dhe të trajtohen çështje të tjera që kanë të bëjnë me të

Çdo gjë që njerëzit e konsiderojnë udhëtim, është e tillë, pa marrë parasysh distancën, nëse është e madhe apo e vogël dhe as kohëzgjatjen, nëse është e gjatë apo e shkurtër. Kriteri bazë që i referohet kësaj çështje është *el-urfi*, zakoni apo tradita e njerëzve të atij vendi apo e shumicës së tyre, dhe jo e disa personave. Nuk ka argument të saktë dhe të qartë që do ta përkufizonte këtë gjë. Ky është qëndrimi i disa dijetarëve.

Zakoni (apo tradita) nuk del jashtë tri situatave vijuese:

- Ajo për të cilën banorët e vendit ndajnë të njëjtin mendim, në lidhje me distancën e

udhëtimit, gjatë të cilit lejohen të zbatohen lehtësimet fetare dhe aplikohen dispozitat e udhëtimit.

- Kur ka konsensus për distanca të caktuara, të cilat nuk konsiderohen distanca udhëtimi dhe për to nuk lejohen të zbatohen lehtësimet fetare dhe nuk aplikohen dispozitat e udhëtimit.
- Në rastin kur ka mospajtime që kjo apo ajo distancë është apo nuk është distancë udhëtimi. Edhe për këtë rast nuk lejohet të zbatohen lehtësimet fetare të udhëtimit, ngaqë provat dhe argumentet duhet të jenë të sakta e të qarta.

Gjithashtu është thënë se largësia 88 km konsiderohet distancë udhëtimi, në të cilin lejohen lehtësimet fetare dhe ky është mendimi i shumicës së juristëve islam. Në fakt, ky është mendimi më i sigurt për llogaritjen e distancës së udhëtimit, sidomos kur nuk dihet tradita ose ajo nuk është e qartë dhe e mirëpërcaktuar.⁴

⁴ Dijetarët ndajnë mendime të ndryshme sa i përket përcaktimit të asaj që quhet *el-fersekh* (njësi për matjen e largësisë në të kaluarën). Për këtë arsye, përllogaritja e distancës së udhëtimit varion nga 70 deri në 120 km.

Në të gjitha rastet për udhëtarin zbatohen dispozitat e udhëtimit, sido që të jetë ai:

1. Udhëtim *mubah* (i lejuar) apo *mustehab* (i preferuar), madje edhe *haram* (i ndaluar), kur udhëton për të bërë ndonjë gjynah.
2. Kush udhëton me qëllim që ta prishë agjërimin apo për ta shkurtuar namazin, këtij nuk i lejohet të përfitojë nga lehtësimet fetare të udhëtimit, për arsye se ky përdor hile e dredhi për të shkelur kufijtë e Allahut.
3. Dispozitat e udhëtimit në det janë të njëjta me ato në tokë, nëse përshkohet distanca në bazë të *urfit* (zakonit) që i lejon lehtësimet fetare.
4. Merret në konsideratë distanca e udhëtimit, pa marrë parasysh për sa kohë përshkohet ajo. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam.
5. Për llogaritjen e distancës së udhëtimit merret në konsideratë vetëm vajtja, jo vajtje e kthim.
6. Nëse një person dyshon për distancën që ka përshkuar, a të mbështetet tek *urfi* (tradita) për të përfituar lehtësimet fetare apo jo?

Përgjigjja: Ky person konsiderohet vendas dhe nuk i lejohet të përfitojë nga lehtësimet fetare të udhëtimit, siç janë: shkurtimi i namazeve, prishja e agjërit etj. Ky është opinionimi i shumicës së juristëve.

7. Kur dikush ka dy rrugë:

- të largët, e cila e arrin distancën e udhëtimit;
- të afërt, e cila nuk e arrin distancën e udhëtimit;

Në këtë rast:

- a) Nëse për ndonjë arsye nuk mund të udhëtojë përmes rrugës së afërt, si dhe nuk ka për qëllim të bëjë hile për të përfituar nga lehtësimet e udhëtimit, atëherë i lejohen lehtësimet fetare të udhëtimit. Ky është opinionimi i shumicës së juristëve islam.
- b) Nëse me marrjen e rrugës së largët ka për qëllim shëtitjen, atëherë i lejohet të përfitojë nga lehtësimet fetare të udhëtimit.
- c) Nëse mund t'i bjerë rrugës së afërt dhe nuk ka arsye që e pengon, e megjithatë ai

i bie rrugës së largët, pa pasur për qëllim përfitimin nga lehtësimet fetare të udhëtimit, atëherë atij i lejohet ky veprim.

- d) Nëse i bie rrugës së largët duke dashur të bëjë hile për të përfituar nga lehtësimet e udhëtimit, atëherë atij nuk i lejohet të përfitojë nga lehtësimet e udhëtimit. Ky është opinioni i shumicës së juristëve.

Kur e ku fillon aplikimi i dispozitave të udhëtimit?

1. Nijeti i udhëtimit është kusht, pa të nuk mund të përfitohet lehtësimet fetare të udhëtimit. Kështu që, nëse ndonjëri del për të kërkuar ndonjë të humbur ose del për shëtitje dhe nuk e ka për qëllim udhëtimin, edhe nëse e përshkuan distancën që ia mundëson përfitimin e lehtësimeve fetare të udhëtimit, atëherë këtij personi nuk i lejohet t'i përfitojë këto lehtësime, sepse i mungon nijeti (motivimi). Ky është mendimi i katër imamëve të katër *medh'hebeve* (shkollave juridike).

2. Njeriu fillon të përfitojë nga lehtësimet fetare të udhëtimit në momentin kur lë pas shtëpitë apo ndërtesat e vendit të tij. Ndërsa kur është brenda territorit të vendit të tij, nuk i lejohet të përfitojë nga këto lehtësime, sipas konsensusit të dijetarëve.
3. Pasi lë pas shpine shtëpitë apo ndërtesat e vendit të tij dhe kalon nëpër kopshte apo ara pranë të cilave nuk jeton askush gjatë tërë vitit, këto nuk i merr parasysh dhe lehtësimet fetare për të kanë filluar qysh në momentin që ka lënë pas shtëpitë e vendit të tij, të cilat janë të banuara gjatë tërë vitit. Nëse në rrugë sheh fabrika apo kompani të ndryshme, gjithashtu edhe këto nuk i merr parasysh. Ndërsa kur pranë tyre ka shtëpi apo vendbanime ku banojnë e jetojnë punëtorë, atëherë lehtësimet fetare për të fillojnë atëherë kur t'i lërë pas këto shtëpi apo vendbanime punëtorësh. Ky është opinioni i shumicës së juristëve.

4. Me fjalën “shtëpi” apo “ndërtesë” kemi për qëllim ato shtëpi apo ndërtesa që janë të dukshme nga rruga ku udhëtojmë, ndërsa kur ato janë të fshehta, si p.sh. pas kodrave apo bjeshkëve dhe nuk janë afër rrugës ku jemi duke udhëtuar, atëherë nuk merren parasysh. Sigurisht, nga lehtësimet fetare të udhëtimit përfitojmë atëherë kur i lëmë pas shtëpitë apo ndërtesat që janë pranë rrugës.
5. Çdo shtëpi apo ndërtesë, e cila sipas *urfit* (traditës) është pjesë e vendit (qytetit apo fshatit), duhet të konsiderohet e tillë dhe nuk lejohet të aplikohen lehtësimet fetare të udhëtimit vetëm atëherë kur lihen pas shpine këto vendbanime.
6. Lehtësimet fetare të udhëtimit aplikohen kur vendbanimet të lihen pas me trup e jo me shikim, ndërsa gjatë kthimit këto lehtësime aplikohen deri në momentin kur udhëtari arrin në vendin e tij, pra kur përfundon udhëtimi. Ky është opinioni i gjithë dijetarëve.

7. Lehtësimet e udhëtimit për atë që udhëton me avion fillojnë në momentin që avioni i kalon vendbanimet në lartësi, e jo kur ai del nga zona e hapësirës së fluturimit të vendit. Ndërsa gjatë kthimit këto lehtësime aplikohen deri në momentin kur avioni është paralel me këto vendbanime.
8. Cila është mënyra e llogaritjes së distancës së udhëtimit?

Si pikë destinacioni merret vendi për ku udhëtohet apo pika e hyrjes së atij vendi (qytet apo fshat)?

Kemi dy raste:

- a. Nëse qëllimi i vizitës është një vend që gjendet pas qytetit (apo fshatit) dhe se ky vend është i ndarë nga qyteti (apo fshati), përmes të cilit kalohet, atëherë për llogaritjen e distancës merret parasysh vendi që duam të vizitojmë dhe jo qyteti (apo fshati) ku kalojmë.

b. Nëse do të vizitoje një vend brenda qytetit (apo fshatit), atëherë, sipas juristëve islam, merret parasysh pika e hyrjes në këtë qytet apo fshat, për arsye se ata kanë vendosur që lehtësimet e udhëtimit të fillojnë në momentin kur lihen pas vendbanimet.

9. Ndërprerja e vendbanimeve dhe kalimi i vendeve.

E para: Nëse vendbanimet janë pjesë e territorit të vendit, konsiderohen të tilla pa marrë parasysh hapësirën në mes tyre, qoftë ajo e madhe apo e vogël, atëherë lehtësimet fetare të udhëtimit fillojnë pasi kalohet shtëpia apo ndërtesa e fundit e atij vendi, për arsye se dispozitat e udhëtimit fillojnë të aplikohen pas daljes nga vendi.

E dyta: Nëse afër një vendbanimi gjendet një tjetër, atëherë për këtë çështje kemi dy raste:

- Nëse të dy vendet janë të ngjitur me njëri-tjetrin, atëherë lehtësimet e udhëtimit filloj-

në pasi të kalohen të dyja vendet. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam.

- Kur dy vendet janë të ndarë nga njëri-tjetri, qoftë kjo ndarje e vogël apo e madhe, udhë-tari fillon të aplikojë lehtësimet fetare me-njëherë sa kalon vendin e tij.

Kategoritë e njerëzve në raport me vendqëndrimin e përhershëm, me qëndrimin e përkohshëm dhe me udhëtimin

1. Nëse njeriu del nga vendlindja e tij, me qëllim për tu kthyer përsëri, dhe nuk merr nënshtetësi tjetër, në këtë rast ky person konsiderohet udhëtar.
2. Nëse një njeri bëhet banor i një vendi (që nuk është vendlindja e tij), vendos të jetojë në të dhe ka qëllim të shpërngulet në të, atëherë ky vend konsiderohet si vendbanim. Kur ai shkon në vendlindjen e tij për të vizituar të afërmit apo dhe për arsye të tjera, në këtë rast konside-rohet udhëtar.

3. Ai që udhëton në një vend të caktuar, me qëllim që të banojë përherë në të, konsiderohet rezident (jo udhëtar) i atij vendi.
4. Gjatë udhëtimit lejohet aplikimi i lehtësimeve fetare të udhëtimit, me konsensusin e gjithë dijetarëve. Ky quhet “udhëtar në lëvizje”.
5. Nëse udhëtari kalon apo hyn në vendin e tij, qoftë edhe një ditë të vetme, apo kalon përmes tij, atëherë udhëtimi i tij ndërpritet dhe nuk konsiderohet më udhëtar.
6. Për personat që janë në udhëtim të përhershëm, si p.sh.: taksistët, pilotët e aeroplanëve, kapitenët e anijeve etj. Duhet të sqarojmë:
 - a) Nëse ata i kanë me vete familjarët e tyre gjatë udhëtimeve, atëherë mjetet me të cilat udhëtojnë konsiderohen vendbanime të tyre dhe nuk u lejohet t'i aplikojnë lehtësimet fetare të udhëtimit. Ky është opinionimi i shumicës së juristëve.

- b) Nëse nuk i kanë familjarët me vete, atëherë u lejohet të përfitojnë nga lehtësimet fetare të udhëtimit, si p.sh. shkurtimi i namazit etj.

7. Nëse një person udhëton nga vendlindja e tij në një vend tjetër, mirëpo gjatë rrugës, për arsye të caktuara, vendos të kthehet, atëherë a i lejohet atij t'i aplikojë lehtësimet fetare të udhëtimit?

Kemi dy raste:

- a) Nëse distanca e vendit drejt të cilit është nisur konsiderohet udhëtim, atëherë i lejohen lehtësimet e udhëtimit.

- b) Nëse distanca e vendit drejt të cilit është nisur nuk konsiderohet udhëtim, atëherë nuk i lejohen lehtësimet e udhëtimit. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam.

8. Dijetarët ndajnë mendime të ndryshme në lidhje me personin që udhëton drejt një vendi për të punuar apo studiuar, sido që të jetë udhëtimi i tij i kushtëzuar apo jo në një kohë të caktuar ose me një punë të caktuar:

- a) Nëse ky person ka për qëllim të qëndrojë në atë vend katër ditë, apo edhe më shumë, atëherë i plotëson namazet. Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve.
- b) Nëse vendos të qëndrojë nëntëmbëdhjetë ditë, atëherë e shkurton namazin, sepse kështu veproi Pejgamberi (sala Allahu alejhi ue selem) kur çliroi Mekën; e nëse qëndron më shumë, atëherë e plotëson. Ky është qëndrimi i Ibën Abasit (radijAllahu anhu).⁵
- c) *Urfi* (tradita) është ai që përcakton nëse një person quhet rezident (vendas) apo udhëtar. Kur njerëzit e atij vendi e konsiderojnë udhëtar, ai është i tillë; dhe atë të cilin e konsiderojnë vendas, ai është i tillë. Ky mendim mund të shtjellohet si vijon:
- kur sipas zakonisht, konsiderohet vendas, si p.sh. ai që udhëton në një vend për të punuar apo studiuar dhe qëndron atje një vit apo shumë vite;

⁵ Transmeton Buhariu nr. 1080.

- kur sipas zakonit, konsiderohet udhëtar, si p.sh. ai që udhëton për kryerjen e haxhit apo umres, ose ndërmerr një udhëtim turistik apo për t'u kuruar në një vend dhe qëndron atje një apo dy muaj, e kështu më radhë;
- kur sipas zakonit çështja është e diskutueshme, në këtë rast merret në konsideratë mendimi dominant, nëse i plotëson kushtet e vendqëndrimit apo të udhëtimit? P.sh. Ai që qëndron në një vend për disa muaj rresht në kërkim të dijes apo duke punuar, ky është një rast i diskutueshëm që i përmban të dyja mundësitë: të quhet rezident (vendas) ose udhëtar; mendimi më afër së vërtetës është: quhet rezident me qëndrim të përkohshëm.

Të gjitha këto mendime janë të forta, mirëpo ajo çfarë kërkohet, në raste të tilla, është marrja në konsideratë e asaj që është më e sigurt, se-

pse bëhet fjalë për dy vepra të cilat janë prej shtyllave të Islamit.⁶

9. Nëse një njeri udhëton në një vend të caktuar, qëndron atje për ndonjë punë, që nuk di se kur do ta përfundojë, këtij i lejohej të përfitojë nga lehtësimet fetare të udhëtimit. Të këtij mendimi janë të gjithë juristët islamë. Gjithsesi ai duhet të shohë, nëse mendon se mund të qëndro-

⁶ Raste praktike:

1. Nxënësit, qofshin ata brenda shtetit të tyre apo edhe studentë me bursa, të cilët qëndrojnë disa vite në një vend të caktuar duke e ditur kohën e kthimit për në vendlindje, ata nuk konsiderohen udhëtarë. Në një rast si ky njeriu duhet të bëjë kujdes në marrjen e fetvave dhe zbatimit të lehtësimeve fetare, edhe nëse ka ndonjë dijetar që përkrah mendimin e kundërt. Çfarë e dëmton atë që ta plotësojë namazin, ndërkohë që kur e kryen atë të plotë është i bindur se ka bërë më të mirën? Muslimani duhet të ketë kujdes e të mos e nënvlerësojë këtë çështje.
2. Edhe për punëtorët, dhe të tjerët që kanë vendbanime të qëndrueshme, vlejnë të njëjtat dispozita.
3. Kush ndërmerr ndonjë udhëtim turistik, për t'u mjekuar, apo për ndonjë punë të rëndësishme, apo për kryerjen e ndonjë praktike ose udhëton për në Mekë për të kryer haxhin a umren, ndërkohë ky udhëtim zgjat; disa ditë, disa javë apo edhe disa muaj, në të tilla raste ai konsiderohet udhëtar, pa marrë parasysh nëse e ka caktuar kohën e kthimit apo jo.

jë gjatë, atëherë është më mirë të mos aplikojë lehtësimet e udhëtimit. Ky quhet udhëtar me statusin e vendasit të përkohshëm.

10. Personi që posedon shtëpi edhe në vendlindjen e tij, edhe në vendin tjetër ku ka vendosur të jetojë, nëse dëshiron të udhëtojë për në vendlindje për të kaluar atje pushime të shkurtra, si festat e të tjera, atëherë ky ka të drejtë t'i shkurtojë namazet, për arsye se konsiderohet udhëtar. Fakti që posedon shtëpi, nuk ia obligon plotësimin e namazeve në atë vend. Nëse të dy vendet i frekuenton në mënyrë të vazhdueshme, atëherë ky konsiderohet si rezident i dy vendbanimeve (të përkohshme) dhe për këtë arsye nuk konsiderohet udhëtar në të dy vendet. Ndërsa gjatë rrugës për në këto vende konsiderohet udhëtar dhe si i tillë i lejohen lehtësimet fetare të udhëtimit.

11. Kush ka bashkëshorte në një vend dhe udhëton për tek ajo, qëndron në atë vend disa ditë të caktuara, pastaj kthehet për në vendqëndri-

min e tij të përkohshëm, këtij i lejohej të përfitojë nga lehtësimet e udhëtimit, me përjashtim të rastit kur frekuentimi i dy vendeve është i vazhdueshëm. Në këtë rast ai konsiderohet udhëtar.

12. Nëse njeriu vendoset në një vend të caktuar, me qëllim që të jetojë atje, pastaj udhëton drejt vendit të prindërve të tij për t'i vizituar ata, ky mund të përfitojë nga lehtësimet e udhëtimit gjatë kohës së qëndrimit te prindërit.
13. Mbreti, princi apo udhëheqësi që lëviz nga një vend në tjetrin brenda shtetit të vet, nëse e arrin distancën e udhëtimit që ia lejon aplikimin e lehtësimeve fetare, konsiderohet udhëtar dhe përfiton këto lehtësime, me përjashtim të rastit kur ai i frekuenton këto vende në mënyrë të vazhdueshme, atëherë nuk konsiderohet udhëtar. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam.
14. Kush udhëton në një distancë e cila konsiderohet udhëtim, qoftë edhe një ditë të vetme,

pastaj kthehet nga ky udhëtim për në vendlindjen e tij, ky person i shkurton namazet, sepse konsiderohet udhëtar. Ky është mendimi i katër imamëve të *medh'hebeve* (shkollave juridike).

15. Punëtorët, mësuesit, nxënësit etj. që udhëtojnë në çdo ditë, udhëtimi i të cilëve nuk është aq i gjatë, edhe pse përshkojnë distancë të mëdha, është më e sigurt që të mos i shkurtojnë namazet, për shkak se ky udhëtim për ta është bërë i zakonshëm, ndërsa bashkimi i namazeve lejohet në raste vështirësie, por pa i shkurtuar namazet. E nëse udhëtimi i tyre është i gjatë, atëherë u lejohet bashkimi dhe shkurtimi i namazeve.

16. Kush udhëton në një vend për të punuar apo mësuar, dhe qëndron aty gjithë javën, pastaj në fundjavë kthehet në shtëpi, ky person ka të drejtë që gjatë qëndrimit në vendin e punës apo të mësimit të aplikojë lehtësimet e udhëtimit, për arsye se gjendja e tij nuk është e qënd-

rueshme. Ndërsa kur kthehet në shtëpi (në vendlindje), i fal namazet e plotë.

Disa rregulla etike

Kërkimi i lejes nga prindërit për të udhëtuar

Kemi disa raste:

1. Në rastin kur duhet të kryhet detyra e haxhit, nuk është obligim kërkimi i lejes prej tyre, mirëpo është e pëlqyer t'u merret leje. Nëse prindërit e ndalojnë nga ky udhëtim, bindja ndaj tyre nuk është obligim. Nëse dëshiron të kryejë haxh vullnetar, obligohet t'u marrë leje prindërve. Nëse ata nuk dëshirojnë që ai të shkojë, nuk i lejohet të udhëtojë, sepse bindja ndaj tyre është obligim.
2. Kur kërkimi i diturisë është obligim individual dhe ajo nuk mund të mësohet në vendlindje, nuk obligohet t'u marrë leje prindërve, nëse do të udhëtojë në kërkim saj. Sikurse nuk obligohet t'u bindet atyre, nëse të ndalojnë nga ky udhëtim. Kur udhëtimi bëhet me qëllim për të kërkuar dije që nuk është obligim individual, pra kur

bëhet fjalë për dije të pëlqyer (vullnetare - jo të obliguar), atëherë kërkimi i lejes së tyre është obligim. Ndërsa kur kërkimi i dijes është obligim kolektiv (fard kifaje), si në rastin kur nuk ka specialistë të një fushe të caktuar ose ka por janë të pakët ndërkohë që populli ka nevojë për më shumë specialiste dhe ky person është i aftë të specializohet në këtë fushë, atëherë nuk obligohet t'u marrë leje prindërve; gjithsesi është e pëlqyer kërkimi i lejes prej tyre.

3. Udhëtimi për të bërë tregti:

Nëse ky udhëtim bëhet më qëllim plotësimin e nevojave personale apo familjare dhe dëmtohet personalisht apo familjarisht nëse nuk e bën një gjë të tillë, në këtë rast nuk obligohet t'u marrë leje prindërve. Nëse, me këtë tregti, ka për qëllim shtimin e pasurisë, atëherë duhet patjetër t'u marrë leje prindërve.

4. Udhëtimi për të marrë pjesë në luftë:

Nëse në atë vend ku zhvillohet lufta plotësohen kushtet dhe bëhet obligim pjesëmarrja, atë-

herë patjetër duhet të kërkohet leja e prindërve dhe e udhëheqësit. Ky është mendimi i shumicës së juristëve. Në rast se të dy prindërit (apo njëri prej tyre - me kusht që të jenë muslimanë) e ndalojnë të marrë pjesë në luftë, atëherë nuk i lejohet pjesëmarrja në të, për arsye se barmirësia ndaj tyre është obligim individual, ndërsa pjesëmarrja në luftë është obligim kolektiv, me përjashtim të rasteve kur dijetarët thonë se është obligim individual: në këtë rast i jepet xhihadi përparësi para prindërve.

5. Udhëtimi *mubah* (i lejuar) kushtëzohet nga leja e prindërve.

Kriteri që kushtëzon bindjen ndaj prindërve përcaktohet nga dëmi dhe dobia. Rrjedhimisht kemi disa raste:

- a) Nëse personi ka dobi prej udhëtimit dhe nuk dëmtohen prindërit, atëherë nuk është kusht kërkimi i lejes së tyre.

- b) Nëse ai ka dobi prej udhëtimit dhe prindërve të tij u shkaktohet dëm, atëherë leja e tyre është kusht.
- c) Kur ai nuk udhëton, dëmtohet; ndërsa kur udhëton, dëmtohen prindërit e tij: atëherë për këtë rast kemi disa situata:
- Nëse dëmi ndaj personit është më i madh, nuk kushtëzohet kërkitimi i lejes së prindërve; por në rast se dëmi ndaj prindërve është më i madh, është kusht marrja e lejes prej tyre.
 - Nëse dëmi është i njëjtë për të gjithë, atëherë çdo çështje shqyrtohet më vete, sipas kushteve dhe rrethanave. Nuk ka dyshim se bamirësia ndaj prindërve ka grada të ndryshme, mosbindja ndaj tyre është në nivele të ndryshme. Allahu na bëftë të bindur dhe respektues ndaj prindërve dhe i faltë ata që kanë ndërruar jetë!

Nuk mjafton leja e njërit prej prindërve,
por duhet leja e të dyve.

Dobi:

Është pyetur “Shejhu Islam”, Ibën Tejmija (Allahu e mëshiroftë) për udhëtimin e atij që ka fëmijë dhe është përgjigjur: “Nëse për shkak të udhëtimit të tij, dëmtohet familja, atëherë nuk i lejohet të udhëtojë, sepse në një hadith i Dërguari (alejhi selam) thotë: *“I mjafton njeriut si mëkat që t’i lërë pas dore ata që ka nën kujdestari.”*⁷

Preferohet që udhëtari të lërë testament para udhëtimit. Nëse ai ka detyrime ndaj të tjerëve, atëherë lënien e testamentit e ka obligim, ashtu si ka urdhëruar i Dërguari (alejhi selam).⁸

Preferohet që para udhëtimit të përshëndetet familja, shokët, dijetarët etj. Është transmetuar në hadith se Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur

⁷ Hadithin e kanë transmetuar Ahmed (6495) dhe Hakimi (1515) dhe e ka saktësuar Ahmed Shakiri, po ashtu edhe Shuajb Arnauti në verifikimin e *Musnedit* (6495).

⁸ Hadithin e transmeton Muslimi (1672).

prej tij) ka thënë: “*Para se të udhëtonim shkonim tek i Dërguari i Allahut për ta përshëndetur.*”⁹

Preferohet që familja dhe shokët të përshëndeten me këto fjalë: “*Ju lë nën kujdesin e Allahut, të Cilit nuk i humbin amanetet.*”¹⁰

Ndërsa ata e përshëndesin në këtë mënyrë: “*Po i lë amanet Allahut fenë tënde, amanetet e tua (pasuria, familja etj. amanete që u ke njerëzve dhe amanetet që të kanë lënë ata) dhe përfundimin i punëve të tua.*”¹¹ Po ashtu është mirë të thuhet edhe kjo lutje: “*Allahu ta shtoftë devotshmërinë, t’i faltë gjynahet, ta lehtësoftë punën e mirë kudo qofsh!*”¹²

⁹ Hadithin e transmeton Buhariu (2954).

¹⁰ Hadithin e transmetojnë Ahmedi (9230), Ibën Maxheh (2825), Ibën Sunnij (505) dhe të tjerë, ndërsa Albani e saktëson në Sahihun e Ibën Maxhes (2825), kurse Ibën Haxheri e konsideron hasen (të mirë) në librin “*El-Futuhat*” (114/5).

¹¹ Hadithin e transmetojnë Ahmedi (4542), Tirmidhiu, i cili e saktëson (3442), gjithashtu hadithin e saktëson Ahmed Shakiri në verifikimin e *Musnedit* (4542), ndërsa Ibën Haxheri e quan hadith *hasen* (të mirë) në librin “*El-Futuhat*” (116/5).

¹² Hadithin e transmetojnë Tirmidhiu (3444), Darimiu (2713) dhe shtoi këto fjalë: “*Qofsh nën mbrojtjen e Allahut dhe kujdesin e Tij*”. Po

Po ashtu është mirë që udhëtarit t'i jepet porosi për t'u përcjellë selam (përsëndetja islame) njerëzve për tek të cilët është nisur. Kur ai merr përsipër këtë amanet, e ka obligim përmbushjen e tij, sepse amaneti duhet çuar në vend; ndërsa kur nuk e pranon, nuk obligohet ta kryejë atë. Gjithashtu preferohet që personi, i cili do t'i çojë dikujt selam nëpërmjet udhëtarit t'i thotë atij: "*Përcille selamin, nëse ke mundësi*", në mënyrë që të mos e ngarkojë me përgjegjësi.

Preferohet të udhëtojë ditën e enjte, sepse në hadith përmendet: "Pejgamberi (alejhi selam) ka udhëtuar ditën e enjte për në Tebuk. Ai kishte dëshirë që udhëtimet e tij t'i realizonte po në këtë ditë."¹² Nuk lejohet që njeriu të ketë mendime ogurzeza në udhëtim, në çfarëdo dite qoftë ai. Kështu që kurdo që dëshiron të udhëtojë, le të udhëtojë dhe të mos e pengojnë supersticionet.

ashtu edhe Ibën Huzejme (2532). Albani e saktëson në Sahihun e Tirmidhiut (3444), ndërsa Ibën Haxheri në "*El-Futuhat*" hadithin e quan *hasen* (të mirë) (120/5).

Është e preferuar që të niset për udhëtim në fillim të ditës, po ashtu është thënë se edhe natën mund të udhëtojë.

Një thënie interesante: Ibën Rexhebi thotë: “Në fund të natës, në rrugët e kësaj bote, është i lavdëruar udhëtimi me trup, sikurse është e pëlqyer që, në këtë kohë, të udhëtohet drejt Allahut me zemër përmes punëve të mira.”

Është e pëlqyer që paratë që nevojiten për udhëtim t'i lihen njërit prej anëtarëve të grupit dhe secili të derdhë kontributin e vet, në mënyrë që asnjëri të mos ngushtohet.

Ndalohet udhëtimi në grupin e shoqëruar nga qentë apo kambanat, po ashtu ndalohet përdorimi i lëkurave të tigrave dhe të merren me vete në udhëtim. I Dërguari (alejhi selam) thotë: “*Nuk e shoqërojnë engjëjt atë grup, në të cilin ka qen dhe kambana.*”¹³ Po ashtu ka thënë: “*Nuk e shoqërojnë*

¹³ Transmeton Muslimi (2113).

engjëjt atë grup, në të cilin ka lëkurë tigrash."¹⁴ Gjithashtu ka thënë: "*Engjëjt nuk e shoqërojnë grupin që ka me vete këmbora.*"¹⁵

Bën përjashtim grupi që shoqërohet nga qeni që shërben si roje në rast nevojë, sikurse është transmetuar në hadith: "*Me përjashtim të qenit të bagëtive, të gjahut dhe të arave (kopshteve)*".¹⁶

E njëjta dispozitë vlen edhe në rastin kur një person udhëton i vetëm në shoqërinë e qenit.

Udhëtari duhet të përpiket të mësojë rregullat e udhëtimit, qofshin ai udhëtim zakonshëm apo i veçantë si haxhi e umra, apo udhëtim për tregti, apo kur del për gjah etj.; të mësojë sjelljen me njerëzit etj. Të marrë ndonjë libër, që flet për këto çështje, për ta lexuar.

¹⁴ Transmeton Ebu Dauudi (4130). Ka mospajtime për saktësinë e hadithit, ndërsa Neveviu e konsideron hadithin *hasen* (të mirë) në librin "*Al-Hulasa*" (78-1).

¹⁵ Transmetojnë Ahmedi (4811), Nesaiu (5220), ndërsa Shuaib Arnauti e bën të saktë këtë hadith në verifikimin e *Musnedit* (4811), po ashtu edhe Albani në "*Es-Silsiletu es-sahihah*" (1874).

¹⁶ Transmeton Muslimi (1575).

*Disa këshilla prej të parëve tanë të
devotshëm për udhëtarët*

Erdhi një njeri tek i Dërguari i Allahut (alejhi selam) dhe i tha:

“O i Dërguar i Allahut, unë jam udhëtar, ndaj më këshillo.”

I Dërguari i Allahut (alejhi selam) i tha: *“Të porosis që t’i frikësohesh Allahut dhe ta madhërosh Atë (të thuash: Allahu ekber) në çdo vend të lartë.”*

Pastaj tha: *“O Zoti im, mundësoja që ta përshkojë shpejt e pa vështirësi distancën e largët dhe lehtësoja udhëtimin!”*¹⁷

Profeti i Allahut (alejhi selam) kur e dërgoi Muadhin dhe Ebu Musën në Jemen i porosi: *“Lehtësoni dhe mos vështirësoni, përgëzoni dhe mos i largoni njerëzit, bashkëpunoni dhe mos u përçani!”*¹⁸

¹⁷ Transmetojnë Ahmedi (8310), Tirmidhiu (3445) dhe e konsideron *hasen* (të mirë), Hakimi (2481) po ashtu e saktëson, me të pajtohet edhe Dhehebiu. Gjithashtu hadithin e konsideron *hasen* (të mirë) edhe Shuajb Arnauti në verifikimin e *Musnedit* (3038).

¹⁸ Transmeton Buhariu (3038).

Bashkimi, pajtimi dhe mos përçarja janë porosi për të cilat ka nevojë çdo udhëtar. Është e domosdoshme që këto të gjejnë zbatim në jetën e përditshme, sido qofshin në udhëtim apo në vendbanimet e tyre.

Këto këshilla profetike nuk zbatohen në përditshmërinë e shumë muslimanëve, për pasojë te shumë komunitete, mjedise e familje mbretëron konflikti dhe armiqësia.

Jahja El-Lejthij thotë: “Kur u ndava nga imam Maliku, kërkoja prej tij të më këshillonte. Në këshillën e tij, midis të tjerash, më tha: *“Të porosis të jesh i singertë me Allahun, Librin e Tij, të Dërguarin e Tij, me prijësin e besimtarëve dhe me masën e gjerë.”* Pastaj takova Lejthin. Kur erdhi koha të ndaheshim, edhe atij i kërkoja të më këshillonte, siç i kërkoja Malikut dhe ai më tha të njëjtat fjalë.”

Një nënë e këshillon birin e saj para udhëtimit:

“Biri im, ti do të shoqërohesh me të huajt, do të largohesh nga shokët, prandaj njerëzve folu me

fytyrë të qeshur dhe frikësoju Allahut në vetmi dhe publik!”

Po ashtu një nënë tjetër e këshillon djalin e saj me këto fjalë:

“Biri im, kurrë mos e shit fenë tënde dhe mos u bëj koprrac. Kush harmonizon butësinë me bujarinë, ka veshur rrobat më të bukura të moralit.”

Muhamed El-Hidr kur ishte emigrant në Gjermani thoshte: “Largësia përtej deteve dhe oqeaneve nuk ua mundëson shikimin atyre që të kanë nën vëzhgim dhe mbyll gojët e kritikuesve të tu. Nëse dikush të bën thirrje që të prishës dekorine moralit, thuaji: Virtyti nuk ka atdhe (nuk përket vetëm një vendi).”

Kujdes nga mendjemadhësia, bëhu modest dhe mos iu bëj barrë të tjerëve. Muxhahidi thotë: “E shoqërova Ibën Omerin (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) për t’i shërbyer, mirëpo ai më shërbeu mua.”

Kujdes, ruaji parimet dhe vlerat gjatë udhëtimit, kur je në tregje apo në mjedise që shesin parim-

et dhe nderin, nën ndikimin e egos, të epshit, pasurisë me pretekstin e mendimit ndryshe, nga kureshtja e tepruar për të mësuar e zbuluar gjëra të reja, pa pasur nevojë për to.

Nëse udhëton për të kryer ndonjë adhurim, të kesh për qëllim fitimin e kënaqësisë së Allahut. Por edhe një udhëtim të zakonshëm përpiku ta shndërrosh në adhurim duke futur gëzim në zemrat e familjarëve dhe fëmijëve të tu, duke qenë i bindur se do të shpërblehesh për lodhjen dhe për gjithçka që shpenzon për hir të Allahut. Prandaj çdo punë bëje për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe duke shpresuar në shpërblimin e Tij.

Trego kujdes ndaj lutjeve e përmendjes së Allahut gjatë ditës e natës; lexoje Kur'anin në mënyrë të vazhdueshme, sepse shumë njerëz i neglizhojnë këto vepra të mira për shkak të angazhimit me udhëtimin. Kam takuar disa njerëz të mirë që lexojë çdo ditë pesë xhuze nga Kur'ani dhe kurrë nuk e lënë namazin e natës gjatë udhëtimit.

Përzgjedhja e *emirit* (prijësit) në udhëtim dhe çështjet që ndërlidhen me të

1. Cili është gjykimi i sheriatit për përzgjedhjen e prijësit në udhëtim? Është vepër e pëlqyer. I Dërguari (alejhi selam) thotë: “Nëse tre veta udhëtojnë së bashku, atëherë le të zgjedhin për prijës njërin prej tyre.”¹⁹
2. Grupin e udhëheq burri dhe jo gruaja.
3. I jepet përparësi atij që njih më mirë dispozitat e udhëtimit, ndaj atij që ka më shumë dituri rreth dispozitave të fesë, për arsye se përzgjedhja bëhet për qëllime të udhëtimit.
4. Mënyra e përzgjedhjes: Prijësi zgjidhet me konsultim dhe me vullnet të lirë.

¹⁹ Transmetojnë Ebu Dauti (2608) dhe Taberaniu në *El-Evsat* (8093), ndërsa Ebu Hatim në “*Ilel*” (225) e ka saktësuar, duke marrë në konsideratë fjalët e Ebu Selemes, po ashtu edhe Darekutnii në “*Ilel*” (1795) e ka saktësuar. Imam Neveviu në “*El Mexhmu*” (4-390) e ka konsideruar *hasen* (të mirë), ndërsa Sheukani në “*Nejlu el-eutar*” (8-294) e ka saktësuar.

5. Fillimi dhe mbarimi i udhëheqjes së grupit: Fillon kur nis udhëtimi dhe mbaron kur përfundon ai (udhëtimi), për shkak se kjo detyrë ka lidhje me udhëtimin.
6. Kushtet e zgjedhjes së prijësit: Duhet të jenë tre ose më shumë persona që ndërmarrin një udhëtim. Nëse janë më pak se tre, atëherë ata të dy konsultohen më njëri-tjetrin për çështjen e udhëtimit dhe nuk zgjedhin prijës.
7. Bindja ndaj prijësit është detyrë.
8. Është detyrë bindja ndaj prijësit për çështje që kanë të bëjnë me udhëtimin, si p.sh. përgatitja e ushqimit, qëndrimi në ndonjë vend të caktuar për të pushuar etj. dhe jo në çdo gjë, ndonëse nuk është mirë të kundërshtohet edhe për ndonjë gjë që nuk ka lidhje me udhëtimin. Për të tilla gjëra zakoni (apo tradita) luan rol kyç. Nuk është e saktë ajo çfarë praktikojnë disa njerëz duke iu bindur prijësit të udhëtimit në mënyrë absolute; bindja ndaj tij duhet të jetë në punë të mira. Po ashtu nuk i lejohet prijësit

që t'i mendojë bashkudhëtarët e tij duke i urdhëruar të bëjnë gjëra që nuk kanë mundësi.

9. Nëse ka mospajtime ndërmjet prijësit dhe bashkudhëtarëve të tij në lidhje me drejtimin e Kiblës, atëherë ata nuk e kanë për detyrë t'i binden atij, për arsye se nuk i përket atij kjo çështje; e njëjta gjë vlen edhe për adhurimet e tjera.
10. Ai që ka më shumë dituri për Librin e Allahut, ka më shumë të drejtë të prijë në namaz, sesa prijësi i grupit, sepse në hadith transmetohet: *“Nëse janë tre veta në udhëtim, le t'u prijë në namaz njëri prej tyre, ndërsa më me meritë është ai që ka më shumë dituri rreth Kuranit.”*²⁰

Lutja profetike gjatë udhëtimit

Është e preferuar lutja e udhëtimit, në vajtje dhe kthim. Lutja bëhet në momentin kur hipën në mjetin e udhëtimit, e jo kur dilet nga vendi.

Udhëtari thotë tre herë: *“Allahu ekber, Allahu ekber, Allahu ekber!”* Pastaj thotë: *“Subhānel-ledhī*

²⁰ Transmeton Muslimi (672).

sekh-hare lenā hādhā, ue mā kunnā lehū mukrinīn, ue inna ilā Rabbinā lemunkalibūn. All-llāhumme innā nes'eluke fī seferinā hādhāl birr-rra uet-takuā, ue minel 'ameli mā terdā, All-llāhummeheuin 'alej-nā seferanāhādhā, uet'ui 'annā bu'dehu, All-llāhumme Ente sahibu fis-seferi, uel khalīfetu fil ehli, All-llāhumme innī e'ūdhu bike min uethāis-sefer, ue keāb-etil mendhari, ue sūil munkalebi fil māli uel-ehli."

"Allahu është më i madh! Allahu është më i madh! Allahu është më i madh! I pastër nga të metat është Ai që na dha mundësi ta përdorim këtë (kafshë a mjet), se ne nuk do të mund ta kishim atë në përdorim dhe ne me siguri pas vdekjes do të kthehemi te Zoti ynë! O Allah! Ne të lutemi që në këtë udhëtim të na mundësosh të bëjmë vepra të mira, të ruhemi nga gjynahet dhe të bëjmë ato punë të cilat Ti i pëlqen! O Allah! Na e lehtëso udhëtimin dhe na e mundëso ta përshkojmë shpejt dhe pa vështirësi distancën e largët! O Allah! Ti je Shoqëruesi (Ruajtësi dhe Ndihmuesi) ynë në udhëtim dhe Ai që kujdeset për famil-

jet tona. O Allah, më ruaj nga vështirësitë e udhëtimit, nga pamja e gjendja e trishtueshme dhe nga kthimi hidhërues për gjendjen e pasurisë dhe të familjes!”

Kur kthehet thotë të njëjtën lutje duke i shtuar:

“Ājibūne, tāibūne, ‘ābidūne li rabbīnā hāmidūn!”

“U kthjem të penduar, adhures e falënderues ndaj Zotit tonë!”²¹

Në një transmetim është përmendur: *“dhe Ai në dorë të të Cilit i lëmë familjet tona dhe pasurinë tonë”*. Në transmetimin e Muslimit thuhet: *“Kërkojmë mbrojtjen Tënde, na ruaj që mos kthehemi nga besimi në pabesim dhe na ruaj nga lutja e atij që i është bërë padrejtësi.”*²² Po ashtu është përmendur: *“dhe nga kthimi hidhërues për gjendjen e familjes, pasurisë dhe fëmijëve.”*²³

²¹ Transmeton Muslimi (1342).

²² Transmeton Muslimi (1343).

²³ Transmeton Nesaiu (5499), ndërsa Neveviu e saktëson hadithin në *“El-Ijdaḥ”* (49), po ashtu Albani në *“Sahihun Nesai”*.

Ndërsa në një transmetim është përmendur se kur kthehet për te familja e tij thotë: *“Kthehem i penduar te Zoti im, i Cili m’i fal gjynahet”*.²⁴ Kurse në një transmetim tjetër është përmendur: *“Kur ai udhëtoi, pasi i hipi mjetit të udhëtimit bëri shenjë me gishtin e tij dhe tha lutjen e udhëtimit.”*²⁵

Kush e harron ta thotë lutjen në fillim të udhëtimit, mund ta thotë gjatë udhëtimit, sikurse vepr ohet më përmendjen e Emrit të Allahut (thënia: bismilahi) kur merret abdes dhe hahet ushqimi.

Shtesa ajibun (u kthyem) dhe të tjerat pas saj thuhet kur njeriu gjendet afër vendit të tij, siç përmendet në hadith: *“Kur u afruam afër qytetit, ai (alejhi selam) tha: “Ajibune, taibune, abidune li Rabbina hamidun”; kështu vazhdoi derisa hyri në qytet.”*²⁶

²⁴ Transmeton Ahmedi (2311), ndërsa Ibën Haxheri e konsideron hadithin *hasen* (të mirë) në *“El-Futuhât”* (172-5), ndërsa Ahmed Shakiri e saktëson hadithin në verifikimin e *“Musnedit”* (2311).

²⁵ Transmetojnë Tirmidhiu (3438), Nesaiu (5501), ndërsa Albani e saktëson hadithin në *“Sahihu Tirmidhi”*.

²⁶ Transmeton Buhariu (3085).

Kur udhëton për në një vend të caktuar dhe pastaj e vazhdon udhëtimin drejt një tjetër vendi, mjaftohet me lutjen që bëri në fillim dhe nuk është e nevojshme ta përsërisë atë.

Çaste meditimi

Lutja e udhëtimit përmban kuptime madhështore me një ndërthurje të jashtëzakonshme dhe harmoni të mahnitshme, që mishëron urtësi profetike, qasje doktrinale dhe paralajmërime të mëdha.

Në udhëtim preferohet shpeshtimi i lutjeve dhe i *istigfarit* (kërkim i faljes prej Allahut), për arsye udhëtimi është ndër momentet kur pranohen lutjet. Udhëtimi është një situatë ku besimtari duhet ta shfaqë nevojën e tij të madhe për Allah-un përmes lutjeve dhe përgjërimit ndaj Tij.

Kur udhëtari të ndalet në ndonjë vend për të pushuar, është e preferuar që të thotë: *“E’ûdhu bi kelimâtil-lâhit-tâmmâti min sherri mâ khaleka!”*

“Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut prej së keqes së çdo gjëje që Ai ka krijuar!”

Kush e thotë këtë lutje, nuk i bën dëm asgjë derisa të largohet prej atij vendi.²⁷

Është e preferuar që udhëtari ta madhërojë Allahun (të thotë: “Allahu ekber”) nëse ngjitet në një vend të lart, ndërsa kur zbret poshtë ta lavdërojë Atë (të thotë: “SubhanAllah”).²⁸

Kur udhëtari hyn në ndonjë vend, është e preferuar të thotë:

“All-llāhumme Rabbes-semāuātis-seb’i ue mā adhlelne ue rabbel erādīnes-seb’i ue mā aklelne, ue Rabbesh-shejātīni ue mā adlelne, ue Rabberr-rrijāhi ue mādherajne! Es’eluke hajre hādhihil karjeti ue hajre ehlihā ue hajre mā fihā, ue e’ūdhubike min sherrihā ue sherri ehlihā ue sherri mā fihā!

O Allah, Zot i shtatë qiejve dhe i gjithçka që qiejt kanë nën strehë! Zot i shtatë tokave dhe i gjithçka që ato mbajnë! Zot i shejtanëve dhe i atyre që ata i kanë çuar në humbje! Zot i erës dhe i asaj që ato shpërndajnë! Të lutem të më japësh të mi-

²⁷ Transmeton Muslimi (2708).

²⁸ Transmeton Buhariu (2993).

rën e këtij vendbanimi, të mirën që vjen nga banorët e tij, të mirën e gjithçka që gjendet në të! Të kërkoj të më mbrosh nga dëmi i këtij vendbanimi, dëmi i banorëve të tij dhe dëmi i gjithçka që ka në të!”²⁹

Udhëtimi i vetëm nuk është i pëlqyer, nëse ekziston mundësia për të pasur shoqërues, për shkak se i Dërguari (alejhi selam) e ndalonte këtë gjë,³⁰ si dhe për shkak të mundësisë së dëmtimit prej hajdutëve. Në raste të tilla, askush nuk mund t’i vijë në ndihmë njeriut, përveç Allahut Fuqiplotë.

Është e pëlqyer që udhëtari të kërkojë shoqërues të devotshëm, që e mësojnë për mirë dhe e ndalojnë nga e keqja, që synojnë të kënaqin bashkudhëtarët, t’ua plotësojnë dëshirat dhe të mos grinden më ta, të jenë durimtarë dhe të mëshirshëm, t’u japin shokëve hakun që u takon, t’i vlerë-

²⁹ Transmeton Ibën Hibani (1709), Hakimi e saktëson (2488), Dhehebiu pajtohet me të, ndërsa Ibën Haxheri e konsideron hadith *hasen* (të mirë) në “*El-Futuhat*” (154/5).

³⁰ Transmeton Buhariu (2998), po ashtu edhe Tirmidhiu, Tirmidhiu e cilëson hadithin *hasen* (të mirë) (1673).

sojnë meritat e bashkudhëtarëve dhe të mos gjurmojnë gabimet e tyre.

*Nëse e shoqëron dikë në udhëtime,
bëhu për të si një i afërm i mëshirshëm.*

Vërejtje dhe paralajmërim!

Duke medituuar rreth faktit që i Dërguari (alejhi selam) e ndalon njeriun që të udhëtojë i vetëm, do të gjesh në të urtësi dhe dobi të mëdha. Kemi dëgjuar dhe kemi parë çfarë se u ka ngjarë atyre që kanë udhëtuar të vetëm: janë keqtrajtuar dhe janë ekzekutuar, kanë rënë në kurthe e intriga, kanë pësuar devijime. Edhe nëse udhëtari është njeri i mençur, gjithsesi ndodh nganjëherë që duke udhëtuar i vetëm të dobësohet shpirtërisht.

Çfarë është thënë për udhëtimin?

Kush është i mirë në udhëtim, është i mirë dhe si rezident. Dikush mund të jetë i mirë në vendin e vet, por nuk është i tillë në udhëtim.

Udhëtimi shfaq të fshehtat dhe tregon moralin e njerëzve. Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) thotë: *“Udhëtimi është kriter vlerësimi për njerëzit.”*

Imam el-Xhuejni është pyetur: “Përse konsiderohet udhëtimi pjesë e dënimit?” Ai u përgjigj: “Për arsye se të ndan nga të dashurit.”

Ibën Haxheri thotë: *“Njeriu në udhëtim mund të veshë edhe rroba që zakonisht nuk i vesh në vendin e vet.”* Por me kusht që të mos përmbajnë gjëra të ndaluara nga sheriat.

Bujaria, distancimi nga grindjet e mosmarrëveshjet, shakaja me bashkudhëtarët, por jo në gjëra që e zemërojnë Allahun si dhe kujtimi e tyre për mirë pas ndarjes me ta, të gjitha këto janë prej fisnikërisë dhe dinjitetit udhëtarit.

Çështje që i përkasin sferës së besimit

1. Nuk lejohet udhëtimi në vendet jobesimtare, vetëm në rast se plotësohen këto kushte:
 - a. udhëtimi dhe qëndrimi në ato vende të jetë i nevojshëm;

- b. të këtë besim dhe dije të mjaftueshme, me të cilat mund të mbrohet nga dyshimet dhe pasionet e dëmshme;
 - c. të këtë mundësi që në ato vende t'i praktikojë ritualet e fesë.
2. Nuk lejohet udhëtimi për argëtim e dëfrim në vendet ku është përhapur shthurja e degjenerimi, nëse njeriu frikësohet nga rënia në imoralitet dhe ligësi.
3. Nuk lejohet udhëtimi për në ato vende që i ka kapluar dënimi i Allahut, sikurse janë vendbanimet e Profetit Salih (alejhi selam), nëse njeriu ka për qëllim shëtitjen apo turizëm. Nëse ky udhëtim bëhet për të marrë mësim e përvojë nga ajo çfarë u ka ndodhur atyre popujve, atëherë mund të udhëtojë pa problem. Udhëtimi për në Detin e Vdekur lejohet. Nuk ka argument bindës se ai ishte vendbanim i popullit të Lutit (alejhi selam).
4. Vizita e vendeve arkeologjike ndahet në:

E para: Udhëtimi posaçërisht për në këto vende:

- Nëse bëhet me qëllim adhurimi, atëherë nuk lejohet, për arsye se besimtari e adhuron Allahun vetëm sipas mënyrës që Ai e ka ligjëruar.
- Nëse shkon për turizëm dhe për të eksploruar, atëherë lejohet me këto kushte:
 - të mos mendojë se kjo vizitë e afron tek Allahu dhe të mos kërkojë bereqet (mirësi) në to;
 - të mos synojë madhërimin e këtyre vendeve nëpërmjet vizitës;
 - në ato vende arkeologjike të mos ketë gjëra të ndaluara, si p.sh. shirk, bidat, të cilat vizitori nuk ka mundësi t'i kundërshtojë.

I dyti: Nëse është një vizitë spontane (e paplanifikuar), mendimi më i saktë është se një gjë e tillë lejohet me kushtet e lartpërmendura.

5. Nuk lejohet vizita e të ashtuquajturave “vende të mira” apo “vende të shenjta” në të cilat kërkohet bereqet, duke e menduar si vepër të pëlqyer, si p.sh. shpella Theur, shpella Hira, kodra e Uhudit, kodra e Arafatit, tyrbja e Husejnit, e Zejnebit, e Salahudinit, e Bedeuiut dhe të tjerë. Gjithashtu në këto vende nuk lejohet namazi, lutja, tauafi, dhikri, apo marrja e dheut për shërim etj. Të gjitha këto janë prej bidateve e veprave të këqija që nuk i kanë praktikuar brezi më i mirë, shokët e të Dërguarit (alejhi selam).

Vërejtje!

Në kohën tonë udhëtimi në disa vende ka marrë përmasa të mëdha. Shumë njerëz nuk e shohin problem udhëtimin drejt vendeve ku ka shthurje dhe imoraliteti bëhet në publik. Udhëtimi i panevojshëm është bërë fenomen shqetësues. Njerëzit garojnë dhe mburren me të tilla vizita, të shoqëruar nga bashkëshortet, fëmijët e shokët e tyre, e kanë bërë zakon dhe nuk e kanë për gjë frekuentimin e vendeve ku degenerimi moral duket hap-

tas, siç janë tregjet e bregdetet. Dihet që vizita të tilla e zemërojnë Allahun dhe kanë efekt negativ në besimin dhe zemrën e vizitorëve. Prandaj besimtari duhet të ketë kujdes. Njeriu është i dobët e mund të ndikohet shumë shpejt nga çfarë sheh dhe dëgjon, teksa dihet shumë mirë se nuk ka gjë më të çmuar sesa besimi, nëpërmjet të cilit sigurohet lumturia në këtë botë dhe në botën tjetër. Besimtari duhet të ketë kujdes që zemra dhe syri i tij të mos mësohen me gjërat e ndaluara.

Besimtarët duhet ta dinë se me këto udhëtime shkatërrojnë atë që kanë ndërtuar me mund e sakrifica për veten dhe familjet e tyre.

Kur të udhëtojnë drejt vendeve të tilla, të kenë parasysh, ta ruajnë besimin dhe mos t'i vizitojnë ato vende ku ka gjëra të ndaluara, po ashtu të kenë kujdes nga lehtësimet e interpretimet e gabuara, të mos mashtrojnë veten (duke gjetur arsye për ndalesat), e të mos e dëmtojnë besimin, moralin dhe sjelljen.

Ndërsa sa i përket atyre që justifikohen për gjynahet duke pretenduar se edhe në vendlindjet e tyre ka mëkate, shthurje e degjenerim, u themi se ka dallim të madh mes fenomenit që ndodh spontanisht dhe nuk është shumë i theksuar dhe atij që është i organizuar dhe ndodh në publik. Sigurisht që Kurani dhe Suneti nuk lejojnë frekuentimin e vendeve ku ka shthurje e degjenerim, më përjashtim të rasteve kur vizita është e nevojshme ose e domosdoshme.

Dispozitat e pastërtisë

1. Urinimi në det është i lejuar; nuk lejohet urinimi në lumenj të vegjël që kanë rrjedhje të dobët ujore, as pellgje uji i të cilave nuk rrjedh, për arsye se bëhen të papastrat shpejt dhe në shumicën e rasteve përdoren nga njerëzit.
2. Ndalohet jashtëqitja në ujë, qoftë shumë apo pak, në lëvizje apo jo, si p.sh. uji i pellgjeve dhe i përrenjve të vegjël, për arsye se një veprim i tillë e ndot ujin dhe se në shumicën e rasteve ai përdoret nga njerëzit; ndërsa jashtëqitja në det

nuk ndalohet, mirëpo njeriu duhet të largohet nga bregu i detit, që mos dëmtojë njerëzit dhe mos e ndotë mjedisin.

3. Me konsensusin e dijetarëve ndalohet kryerja e nevojave personale nën hijet që përdoren nga njerëzit dhe në rrugë të frekuentuara. I Dërguari i Allahut (alejhi selam) ka thënë: *“Ruajuni nga dy të mallkuar.”* I thanë: “Kush janë ata dy të mallkuarit, o i Dërguari i Allahut?” Ai tha: *“Ai që kryen nevojat personale në rrugën e frekuentuar nga njerëzit dhe nën hijet e përdorura prej tyre.”*³¹
4. Është e ndaluar kryerja e nevojave personale nën hijen e pemës me fryte, për arsye se ky veprim i neverit njerëzit dhe i dëmton frytet. Lëndimi i njerëzve dhe dëmtimi i mjedisit janë dy gjëra të ndaluara.
5. Nuk është e urryer kryerja e nevojave personale nën pemët që nuk kanë fryte dhe hijet e të cilave nuk janë vendpushim për njerëzit.

³¹ Transmeton Muslimi (269).

6. Ai që dëshiron të kryejë nevojat personale duhet të mbulohet dhe të largohet nga sytë e njerëzve, me këtë mendim pajtohen unanimisht të gjithë dijetarët. Pejgamberi (alejhi selam): ka thënë: “*Askujt nuk i lejohet të shohë aurretin e tjetrit.*”³²
7. Me konsensusin e dijetarëve lejohet marrja e abdesit me ujin e detit, të lumenjve e të pellgjeve.
8. Marrja abdes me atë ujë që ka ndryshuar ngjyrën nga pemët, algat, argjila apo edhe qëndrimi i gjatë ose ndryshku po ashtu është e lejuar me konsensus të dijetarëve.
9. Lejohet marrja abdesit me ujin që ka ndryshuar erën për shkak të ndonjë papastërtie e cila ka qenë afër tij; kur ka ndryshuar shijen dhe ngjyrën njëkohësisht, nuk merret abdes prej tij, me konsensusin e dijetarëve.
10. Kur ka dyshim në pastërtinë e ujit dhe nuk dihet gjendja e tij paraprake, atëherë merret në

³² Transmeton Muslimi (338).

konsideratë origjina e tij që është pastërtia, prandaj lejohet marrja abdesit me të.

11. Nëse udhëtarit i bëhet obligim gusuli (larja e plotë e trupit) për shkak të xhunubllëkut në kohë shumë të ftohtë dhe ai nuk mund të përdorë ujin nga frika se mos sëmuret, ose nuk mund të gjejë diçka për ta ngrohur, ose gjen mjet për ta ngrohur, mirëpo nëse e bën këtë mund të dalë koha e namazit, atëherë në këto raste lejohet të marrë tejemum. Ky është opinioni i shumicës së juristëve islame. Nëse ka pak ujë dhe nuk i mjafton për t'u pastruar nga xhunubllëku, atëherë me atë ujë merr abdes, ndërsa në vend të larjes së trupit merr tejemum. I njëjti rregull vlen edhe për abdesin. Në momentin që gjen ujë, i bëhet obligim larja me të.
12. Për të marrë tejemum përdoret dhë, në rastin kur nuk ka ujë apo frikësohet nga përdorimi i tij për shkak të ndonjë sëmundjeje apo për di-

çka tjetër. Nëse nuk gjen dhë, atëherë merr tejemum me çfarëdo gjë që gjendet mbi tokë.

13. Udhëtari në aeroplan apo në një vend ku nuk ka ujë dhe që nuk gjen diçka me të cilin mund të marrë tejemum, në këtë rast ai falet në gjendjen që është. Allahu në Kur'an thotë:
"Frikësojuni Allahut aq sa keni mundësi."
14. Nuk është i vlefshëm tejemumi në tapetin aeroplanit dhe ndenjëset e tij etj., për arsye se këto nuk janë dhë nga toka dhe as pjesë të saj.
15. Udhëtari u jep *mes'h* mestëve (apo çorapeve) tre ditë e tre net, ndërsa vendasi një ditë e një natë. Koha e *mes'hit* fillon të llogaritet me *mes'hin* e parë pas prishjes së abdesit, ndërkohe që çorapet i ka veshur pasi i ka larë këmbët.
16. Nëse personi u jep *mes'h* mesteve të tij duke qenë vendas, pastaj udhëton, atëherë *mes'hi* i tij konsiderohet *mes'h* udhëtari.
17. Nëse e fillon *mes'hin* gjatë udhëtimit, pastaj arrin në vendin e tij, atëherë ai llogaritet si

mes'h vendasi. Ky është opiniononi shumicës së juristëve.

18. Nëse e prish abdesin duke qenë vendas, pastaj udhëton para se t'u japë *mes'h* mesteve, atëherë i llogaritet si *mes'h* udhëtari, me konsensus të dijetarëve.

19. Nëse i vesh mestet (apo çorapet) dhe pastaj udhëton para se ta prishë abdesin, atëherë i llogaritet si *mes'h* udhëtari, me konsensus të dijetarëve.

20. Nëse dikush dyshon për kohën e fillimit të *mes'hit*: në kohën kur i fërkoj mestet e tij a ishte vendas apo udhëtar, atëherë më e sigurt është ta llogaritet atë *mes'h* vendasi.

Dispozitat e ezanit

1. Është e pëlqyer thirrja e ezanit dhe e ikametit për udhëtarët, qofshin ata grup apo një person. Ky është opiniononi shumicës së juristëve.
2. Nëse një namaz falet pa ezan dhe pa ikamet ose vetëm me ikamet, atëherë ky namaz është

në rregull. Ky është opinioni i shumicës së juristëve.

3. Nëse disa udhëtarë hyjnë në një xhami ku është thirrur ezani më parë, atëherë këta mjaftohen me atë ezan dhe bëjnë vetëm ikametin që të mos shkaktohet rrëmujë te njerëzit.
4. Lejohet ta thërrasë ezanin udhëtari që ka hipur në mjetin e udhëtimit, qoftë veturë apo aeroplan.
5. Thirrja e ezanit ulur në aeroplan është e lejuar, nëse ka arsye për këtë; ndërsa kur nuk ekziston ndonjë arsye, atëherë përsëri lejohet, por nuk është e pëlqyer. Ky është opinioni i shumicës së juristëve islam.
6. Preferohet të thirret ezani në drejtim të Kibles dhe thuhet se për këtë dijetarët kanë rënë konsensus; ezani mund të mos thirret në drejtim të Kiblës, mirëpo kjo nuk është e pëlqyer.

Dispozitat për namazin

1. Mbulimi i aurretit në namaz nga kërthiza deri te gjuri është kusht. Namazi është në rregull edhe sikur të falet me supe të zbuluara. Ky është opinionimi i shumicës së juristëve, por më e mira është të mbulohen këto pjesë nëse ekziston mundësia, në respekt ndaj Allahut, për të shmangur mospajtimet mes dijetarëve dhe duke qenë se kjo vepër konsiderohet e papëlqyer.
2. Kërkimi i drejtimit të Kibles në udhëtim është obligim, për arsye se namazi në drejtim të saj është kusht.
3. Kush e fal namazin jo në drejtim të Kibles pa e kërkuar atë, ndërkohë që ka mundësi ta kërkojë, ai duhet ta përsëritë namazin. Ky është opinionimi i shumicës së juristëve.
4. Në rastin kure fal namazin jo në drejtim të Kibles, pasi më parë kishte kërkuar dhe ishte mundur për ta gjetur, teksa është në rrugë gjatë udhëtimit të tij apo është jashtë vendbanimeve,

ai nuk ka nevojë ta përsërisë namazin. Ky është opinionioni i shumicës së juristëve.

5. Kur udhëtari, pas kërkimit të Kiblës, e fal namazin jo në drejtim të saj, pasi është ndalur në ndonjë vendbanim nuk është e nevojshme ta përsërisë namazin, për arsye se ai bëri përpjekje për ta gjetur drejtimin e Kibles. Ky është opinionioni i shumicës së juristëve.
6. Nëse një vendas e njofton një udhëtar për drejtimin e kibles, mirëpo pastaj bëhet e qartë se e kishte gabim, atëherë nuk ka nevojë ta përsërisë për arsye se ai i shfrytëzoi të gjitha mundësitë për ta gjetur kiblen. Ky është mendimi i shumicës së juristëve.
7. Nuk pranohet fjala e jobesimtarit që tregon drejtimin Kibles. Ky është opinionioni i shumicës së juristëve, për arsye se drejtimi i Kiblës ka të bëjë me adhurimet e jo me marrëdhëniet njerëzore të kësaj bote. Po ashtu është thënë se pranohet fjala e jobesimtarit, nëse ai është

person i besueshëm dhe i drejtë, dhe kjo është e saktë.

8. Udhëtari duhet ta falë namazin të plotë, kur falet pas vendasit. Ai mund ta falë namazin, i vetëm ose me udhëtarët e tjerë, sikurse ka të drejtë ta shkurtojë namazin e dytë.
9. Namazi vullnetar në anije nuk kushtëzohet të falet në drejtim të Kibles. Falja në drejtim të Kiblës, qëndrimi në këmbë, qëndrimi i mjaftueshëm në ruku dhe në sexhde janë kushte në namazin farz (obligativ). Kur anija, gjatë lundrimit, ndryshon drejtimin duke devijuar nga Kibla, atëherë përpiqet aq sa mundet të ruajë drejtimin. Në kushte pamundësie nuk është i domosdoshëm qëndrimi në këmbë. Ky është opinioni i shumicës së juristëve.
10. Praktikimi i suneteve gjatë udhëtimit është ve për e pëlqyer. Pra, është mirë të falë sunete të tilla si: namazi i vitrit, namazi i duhasë dhe namazi i natës, ndërkohë sunetet para dhe pas

namazeve farz nuk falen, me përjashtim të sunetit të sabahut.

11. Dhikri pas namazit të sabahut deri në lindje të diellit është sunet për udhëtarin në çfarëdo vendi që të jetë ai: në aeroplan, në anije, në hotel e kudo qoftë, pa marrë parasysh a është falur me xhemat apo i vetëm, në mënyrë që të fitojë shpërblimin e përmendur në hadithin e Profetit (alejhi selam): *“Kush e fal namazin e sabahut, pastaj e përmend Allahun deri në lindje të diellit, pastaj i fal dy rekate pas lindjes së tij, shpërblehet sikur të ketë kryer një haxh dhe një umre të plotë, të plotë, të plotë.”*³³

12. Kur njeriu është në aeroplan ulur në karrigen e vet, cili është veprimi më e drejtë që mund të bëjë: namazin e vitrit ta falë në fillim të natës

³³ Transmeton Tirmidhiu (586), ndërsa Ibën Haxheri e konsideron hadithin *hasen* (të mirë) në *“Tahrîxh el-mishkat”* (434/1), po ashtu edhe Albani në Sahihu Tirmidhi, shiko *“Bug’jet el-mushtak fi ahkami xhelseti el- ishrak”*, autor Fehd El-Amari.

para udhëtimit apo ta vonojë deri në fund të natës?

Ai në këtë rast mund të zgjedhë çfarë të dëshirojë. Po ashtu është thënë se më e drejtë është të veprojë çfarë i bën më mirë për zemrën e tij, për arsye se pastërtia e zemrës dhe përmirësimi i saj konsiderohet prej qëllimeve më të larta në raport me adhurimin e Allahut.

13. Shtimi i suneteve të pakushtëzuara është prej veprave më të mira që mund të bëjë udhëtari në Mekë dhe shpërblimi i tyre është shumë i madh, ndërsa falja e suneteve që kushtëzohen me kohët e namazeve nuk është prej traditës së Profetit (alejhi selam) në udhëtim.

14. Kur ka hyrë koha e namazit dhe ai që do të udhëtojë është ende në vendin e tij, nuk i lejojnë lehtësimet fetare të udhëtimit, për arsye se ato fillojnë menjëherë pasi lë pas shtëpitë e vendit të tij. Është thënë se për këtë ka konsensus.

15. Nëse udhëtari e fillon udhëtimin dhe i kalon shtëpitë e vendit të tij pasi ka hyrë koha e namazit, atëherë në këtë rast ai e shkurton namazin, ndërsa kur mbërrin në vendin e tij pas hyrjes së kohës së namazit, e fal atë të plotë. Ky është mendimi i shumicës së juristëve.
16. Kur aeroporti gjendet jashtë vendit të tij, atëherë udhëtari e shkurton namazin, nëse e ka të rezervuar biletën e fluturimit, ndërsa kur nuk ka bërë rezervim dhe është në pritje, nuk e shkurton namazin për arsye se ende nuk ka siguri nëse do të udhëtojë apo jo.
17. Nëse aeroporti gjendet brenda vendit të tij, udhëtari nuk e shkurton namazin, sido qoftë e ka rezervuar biletën e fluturimit apo jo, për arsye se shkurtimi i namazeve i lejohet vetëm kur i lë pas shpine shtëpitë e vendit të tij.
18. Nëse avioni është duke zbritur dhe udhëtari e fal namazin farz (obligativ) të shkurtuar kur është paralel me vendbanimin e tij, në këtë rast duhet ta përsëritë namazin dhe ta falë të plotë për shkak të ndërprerjes së udhëtimit.

19. Nëse një person harroi ta falte namazin *farz* (obligativ) kur ishte në vendin e tij, pastaj i kujtohet kur është në udhëtim pasi që koha ka kaluar, në këtë rast ai obligohet që atë namaz ta falë të plotë. Ky është opinion i katër imameve të *medh'hebeve* (shkollave juridike).
20. Nëse një person ka harruar ta falë namazin *farz* në kohën kur ishte udhëtar, pastaj i kujtohet pas arritjes në vendin e tij, ndërkaq koha e namazit ka kaluar, në këtë rast e fal atë të shkurtuar. Ky është mendimi i shumicës së juristëve.
21. Nëse një person ka harruar ta falë namazin *farz* gjatë udhëtimit të tij, pastaj i kujtohet duke qenë ende në udhëtim, atëherë e fal të shkurtuar.
22. Nuk lejohet të falen në të njëjtën kohë disa xheme. Të parët tanë nuk e kanë bërë një veprim të tillë.
23. Nijeti për shkurtimin e namazit:
Nuk është kusht ky nijet, sepse dihet që namazi në udhëtim shkurtohet. Kështu thonë një

grup juristësh. Nijeti i plotësimit të namazit apo i shkurtimit të tij nuk ka efekt në namaz, në bazë të mendimit më të saktë.

Këtu kemi disa çështje:

- Nëse xhematliu udhëtar bën nijet faljen e namazit të plotë, ndërsa imami i tij e fal atë të shkurtuar, atëherë edhe xhematliu e shkurtton atë.
- Nëse xhematliu udhëtar bën nijet faljen e namazit të shkurtuar, ndërsa imami i tij e fal atë të plotë, atëherë xhematliu domosdoshmërisht duhet ta falë namazin të plotë.
- Nëse udhëtari hyn në namaz, pa e bërë nijet shkurtimin e as faljen e plotë të tij, dhe e fal atë në dy rekate, atëherë namazi i tij është në rregull, sidoqoftë ai imam apo xhematli.
- Nëse udhëtari e fal namazin pas një personi që dyshon a është udhëtar apo vendas, në këtë rast ai e ka obligim të veprojë si imami pas të cilit falet.
- Udhëtari që bën nijet faljen e namazit të plotë, qoftë ky person në pozitën e imamit

apo të xhematliut, ndërkohë kujtohet së
është udhëtar, në këtë rast e fal atë të shkur-
tuar.

24. Me konsensusin e dijetarëve namazet me ka-
tër rekate shkurtohen në dy rekate, ndërsa sa-
bahu dhe akshami nuk shkurtohen.

25. Nëse një person e fal akshamin dy rekate me
mendimin se mund të shkurtohet, në këtë rast
namazi i tij është i pavlefshëm dhe e ka për
detyrë ta përsëritë.

26. Nëse udhëtari bën nijet ta falë namazin e shk-
urtuar, pastaj nga harresa çohet për në rekatin
e tretë, në këtë rast kthehet në pozicionin ku
ishte për ta përfunduar namazin dhe fund bën
sevi sexhde (sexhden e harresës). Ky është me-
ndimi i shumicës së juristëve.

27. Nëse një udhëtar u prin në namaz disa udhëta-
rëve të tjerë dhe nga harresa e fal atë të plotë,
në këtë rast xhematliu nuk e ka obligim pasi-
min e imamit, lejohet që të ndahet prej tij, por
edhe nëse e pason atë, namazin e ka të saktë.

28. Nëse udhëtari e bën nijet ta falë namazin e shkurtuar, pastaj nga harresa e fal atë të plotë, në këtë rast namazi i tij është i saktë, mirëpo i obligohet sexhdeja e harresës.
29. Nëse udhëtari e bën nijet ta falë namazin e shkurtuar, pastaj harron dhe gjatë faljes dëshiron ta falë atë të plotë, e ka këtë mundësi për arsye se shkurtimi i namazit është sunet.
30. Namazi gjatë udhëtimit është sunet të falet shkurtër (të mos zgjatet shumë), madje është thënë se për këtë ka konsensus mes dijetarëve.
31. Është e preferuar që udhëtari në namazin e sabahut të këndojë suren Ez-Zelzele, e cila preferohet të përsëritet në çdo rekat. Është transmetuar se i Dërguari alejhi selam ka kënduar në namazin e sabahut Ez-Zelzele në të dy rekatet.³⁴
32. A është obligim për udhëtarin falja e namazeve me xhemat në xhami?

³⁴ Transmeton Ebu Davudi (816), ndërsa Neveviu e konsideron hadithin *hasen* (të mirë) në librin "*Hulasat el-ahkam*" (1226).

Kemi dy raste:

- a) Nëse udhëtari e dëgjon ezanin duke qenë gjatë rrugës, në udhëtim e sipër, nuk e ka obligim faljen e tij në xhami, edhe nëse ndalet për ndonjë nevojë, pra, në këtë rast, nuk i obligohet falja e namazit me xhemat në xhami.
- b) Nëse udhëtari ka mbërritur në destinacion, atëherë për këtë rast dijetarët ndajnë mendime të ndryshme:

Është thënë: Nëse udhëtari ka mbërritur në destinacionin e dëshiruar, obligohet ta falë namazin me xhemat në xhami, sidoqoftë i vetëm apo me të tjerë (një grup udhëtarësh).

Gjithashtu është thënë: Nëse janë grup udhëtarësh, nuk e kanë obligim faljen e namazit me xhemat në xhami, mirëpo e falin atë së bashku, ndërsa kur është një person, atëherë ai obligohet ta falë namazin në xhami me xhemat.

Shumica e juristëve islam mendojnë se nuk e ka obligim, për arsye se ai është udhëtar. Vetë

namazi është lehtësuar në shtyllat (në gjërat më të rëndësishme) e tij, siç është shkurtimi nga katër rekate në dy, atëherë lehtësimi në vaxhibet (që janë nivel në nivel më të ulët sesa shtyllat) e namazit me xhemat është edhe më i arsyeshëm.

Mirëpo besimtari bën atë që është më e sigurt për fenë e tij, duke pasur parasysh vlerën e madhe që ka namazi me xhemat që falet në xhami, në veçanti ata që udhëtojnë për në Mekë e Medinë, ku vlera e punëve të mira në përgjithësi dhe e namazit në veçanti shumëfishohet: në Mekë brenda kufijve të saj, ndërsa në Medinë në Xhaminë e Profetit (alejhi selam).

33. Për namazin me xhemat në aeroplan ka disa raste:

a) Nëse gjendet vend i mjaftueshëm, ku mund të falet me xhemat, atëherë udhëtarët falet sipas hapësirës së vendit, në xhemate që pasojnë njëri-tjetrit (xhemat pas xhemati).

- b) Nëse gjendet më shumë se një vend ku mund të falet namazi me xhemat, atëherë nuk ka problem nëse falet me një imam për arsye se aeroplani, në të shumtën e rasteve, nuk është shumë i madh.

Mendimi më i saktë është së lidhja e *safave* (rreshtave) është kusht dhe kriterin e vlerësimit të kësaj e vendos *urfi* (tradita).

- c) Nëse një grup udhëtarësh, që kanë ndërmarrë një udhëtim të gjatë, dëshirojnë ta falin namazin, ngase nuk kanë mundësi ta vonojnë derisa të arrijnë në destinacionin e dëshiruar e ta bashkojnë atë në kohën e namazit të dytë, por ata nuk kanë mundësi ta falin vetëm se ulur në ndenjëset e tyre, madje edhe sikur të falej njeriu vetëm nuk do të arrinte ta falte me të gjitha rregullat e tij, në këtë rast u lejohej që ta falin afër njëritjetrit apo disa para e disa të tjerë pas tyre.

Sa i përket qëndrimit të imamatit, se a bën ai të qëndrojë në mes tyre apo ata të qëndrojnë

në në anën e djathtë të tij, më e mira është që xhemati të qëndrojë në të djathtë të imanit dhe ai të mos qëndrojë në mes të tyre, vetëm në rast nevojë, që të largohen nga ato çështje që janë subjekt mosmarrëveshjes mes dijetarëve.

34. Nëse në aeroplan gjendet një vend me hapësirë të mjaftueshme, që një person ta falë namazin e plotë me kushtet e tij, farzet, po ashtu edhe sunetet, a është më mirë që çdo person ta falë namazin i vetëm apo ta falin atë së bashku ulur?

Kemi përmendur më lart se namazi me xhemat nuk është obligim për udhëtarin që është në rrugë. Përderisa është kështu, atëherë i jepet përparësi qëndrimit në këmbë, që është shtyllë e namazit, ndaj faljes me xhemat në udhëtim, që është sunet.

35. Udhëtari nuk ulet në *teshehud* me formën e cila quhet *et-teueruk*, vetëm se në namazin e akshamit, për arsye se *et-teueruku* praktikohet

vetëm në ato namaze që kanë nga dy *teshehude*, siç janë: dreka, ikindia, akshami dhe jacia. Namazi në udhëtim shkurtohet nga katër rekate në dy, ndërsa namazi i akshamit nuk shkurtohet, por mbetet me dy ulje, ku edhe mund të praktikohet forma *et-teuerukut* (në uljen e dytë).

36. Është i lejuar udhëtimi për të falur namazin e xhenazes, për të marrë pjesë në varrim apo për ngushëllim, sepse udhëtimi, në këtë rast, nuk bëhet posaçërisht për të vizituar ndonjë vend. E ndaluar është vizita e qëllimtë e ndonjë vendi, edhe nëse është xhami, varr apo ndonjë gjë tjetër, përjashtim bën vizita e tri xhamive (Mekë, Medinë e Kuds). Lejohet udhëtimi për të vizituar të afërmit, vëllezërit, udhëtimi në kërkim të dijes, për arsye se nuk bëhen për të vizituar qëllimisht ndonjë vend të caktuar.

37. Transporti i xhenazesë nga një vend në tjetrin ka disa raste:

- a) transportimi i të vdekurit nga një vend në tjetrin bëhet obligim, kur nga mostransporti cenohet shenjtëria e tij apo i ekspozohet ndonjë rreziku, si p.sh. kur i vdekuri gjendet në një vend jobesimtar apo në një vend që është në luftë me muslimanët;
- b) nuk është i lejuar transportimi i të vdekurit kur mund të cenohet shenjtëria e tij apo xhenazeja i ekspozohet ndonjë rreziku, nëse vendi ku bëhet varrimi i tij është i sigurt;
- c) është i lejuar transportimi i të vdekurit nga vende jo të largëta, si p.sh. nga fshatrat përreth Mekës e Medinës, nëse nuk arrihet distanca që konsiderohet udhëtim, për arsye se kjo është prej çështjeve të tolerueshme;
- d) transportimi i të vdekurit pa pasur nevojë është një prej çështjeve të diskutueshme mes dijetarëve, mirëpo më e mirë është të mos bëhet një gjë e tillë.

Dispozitat e imamit nga vendasi për udhëtarin dhe e kundërta

1. Namazi pas imamit vendas është i lejuar dhe nuk ka problem nijeti i ndryshëm apo edhe vetë namazi që është i ndryshëm (p.sh. imami vendas falet me nijetin e namazit të ikindisë, ndërsa udhëtari falet me nijetin e namazit të drekës).
2. A është i lejuar shkurtimi i namazit pas imamit vendas, që e fal atë të plotë? Ka dy raste:
 - a) Nëse udhëtari hyn në namaz pas imamit vendas që në fillim apo e fal me të ndonjë rekat, në këtë rast e obligohet ta falë të plotë namazin. Ky është mendimi i shumicës së juristëve.
 - b) Nëse udhëtari arrin më pak se një rekat, atëherë përsëri e fal namazin e plotë. Ky është mendimi i shumicës së juristëve, bazuar hadithin e Dërguarit (alejhi selam):
“Me të vërtetë imami është caktuar që të ndiq-

*et e pasohet.*³⁵ Gjithashtu Ibën Mesudi dhe sahabë të tjerë e falën të plotë namazin pas Uthman ibën Afanit në Mina dhe nuk është transmetuar që dikush prej tyre ta ketë shkurtuar atë.³⁶

Një mësim i vyer: Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) e fali namazin të plotë në Mina pas Uthmanit, kur dihet se ai mendonte se në Mekë namazi duhet shkurtuar (ngase ishin udhëtarë), ndërsa kur e pyetën se përse nuk e shkurtove namazin pas Uthmanit, ai u përgjigj: *“Përçarja është e dëmshme.”* Nga ky veprim duhet të nxjerrë mësimet umeti ynë.

3. Nëse udhëtari hyn në namaz pas një imami vendas, pastaj i bie ndërmend se është i papastër apo pa abdes, e, për pasojë, namazi i tij është i pavlefshëm, në këtë rast ai e përsërit na-

³⁵ Transmetojnë Buhariu (378), Muslimi (411).

³⁶ Transmeton Ebu Dauti (1960), ndërsa Albani e saktëson hadithin në *“Sahih Ebi Daut”*.

mazin dhe kur ta përsërisë atë, mund ta falë të shkurtuar.

4. Një udhëtar hyn në namaz në rekatin e tretë pas një imami duke menduar se edhe ai është udhëtar dhe i fal me të dy rekate, pastaj imami jep selam, po ashtu edhe ky, pastaj i bëhet e qartë se imami është vendas, në këtë rast udhë-tari ngrihet dhe e plotëson namazin me dy rekate të tjera, pra fal gjithsej katër rekate, nëse s'ka kaluar shumë kohë nga *selami* (përfundimi i namazit), por nëse ka kaluar kohë e gjatë nga *selami*, atëherë e përsërit namazin të shkurtuar në dy rekate, për shkak të kohës së gjatë mes selamit dhe momentit kur do ta plotësojë.
5. Lejohet që xhematliu të falë namazin pas një imami që nuk po fal namazin e njëjtë me të, si p.sh. xhematliu fal akshamin, ndërsa imami jacinë, në këtë rast nuk ka problem që falin nama-ze të ndryshme, ashtu si në rastin e namazit që falet në një situatë të frikshme (në luftë).

6. Një udhëtar dëshiron të falë namazin e akshamit pas një imami udhëtar, i cili është duke falur namazin e jacisë, në momentin kur imami jep *selam* (përfundon namazi) xhematliu ngrihet që të falërekatin e tretë. Ndërsa kur imami është vendas, atëherë xhematliu qëndron ulur në rekatën e tretë dhe e pret atë në mënyrë që të japë *selam* bashkë me imamin. Kjo është më e mira. Po ashtu lejohet që pasi imami të ngrihet për në rekatën e katërt, xhematliu ta plotësojë namazin e akshamit (të jap *selam*) dhe të hyjë në namaz me nijetin e jacisë duke u falur pas imamit.
7. Një udhëtar dëshiron të falë namazin e jacisë pas një imami udhëtar apo vendas, i cili dëshiron të falë namazin e akshamit, në këtë rast xhematliu e plotëson namazin e jacisë, për arsye se akshami nuk shkurtohet. Ky është mendimi i shumicës së juristëve.
8. Kur udhëtari dhe vendasi duan të falen së bashku, atëherë e drejta për të udhëhequr nama-

zin i jepet atij që ka më shumë dituri për Librin e Allahut, me përjashtim të rastit kur personi është me pozitë, si p.sh. udhëheqës, imam xhamie apo është pronar i shtëpisë.

9. Lejohet që udhëtari t'i prijë në namaz vendasit. Pas *selamit* (përfundimit të namazit) xhematliu vendas ngrihet dhe i plotëson rekatet e mbetura. Për këtë çështje ka konsensus mes dijetarëve.
10. Nëse vendasi u prin në namaz disa udhëtarëve, pastaj e braktis atë namaz me arsye, ndërkohë vendin e imami e zë njëri prej udhëtarëve, atëherë udhëtari fal vetëm dy rekate, vetëm në rast se imami i larguar ka falur me ata më shumë se dy rekate, atëherë imami i dytë e fal të plotë atë namaz.
11. Nëse një udhëtar u prin në namaz disa vendasve, pastaj largohet nga namazi me arsye dhe zëvendësohet nga një vendas, në këtë rast namazi duhet të falet i plotë.

12. Nëse një apo disa udhëtarë dëshirojnë ta falin namazin pas një imami vendas, që është duke falur teravitë në muajin e Ramazanit, në këtë rast janë dy mundësi:

a) Nëse ata kanë mbërritur në vendlindjen e tyre, atëherë namazin që nuk kanë mundur ta falin, e falin me këtë imam, ndërsa kur të japë selam imami, ngrihen dhe plotësojnë çfarë ka mbetur nga namazi i tyre.

b) Nëse kanë arritur në vendin drejt të cilit kanë udhëtuar, atëherë ata falin pas këtij imami namazin që nuk kanë mundur ta falin rrugës, mirëpo e falin atë të shkurtuar. Nuk është mirë që të falen vetëm, që të mos shkaktojnë rrëmujë.

13. Namazi në xhaminë ku ka varr; ekzistojnë disa mundësi:

a) Nëse varri gjendet jashtë mureve të xhamisë nga mbrapa, në të djathtë apo në të majtë, atëherë namazi është i vlefshëm, me përjashtim të rastit kur është varrezë dhe xha-

mia është ndërtuar mbi varre, atëherë namazi nuk është i vlefshëm.

- b) Nëse varri gjendet jashtë xhamisë në drejtim të Kibles, por ka një ndarje mes xhamisë dhe varrit, si p.sh. mur apo rrugë, në këtë rast lejohet namazi në të, por muslimanit nuk i lejohet që duke u falur të këtë për qëllim drejtimin nga varri.
- c) Nëse varri gjendet brenda xhamisë, në çfarëdo pjesë të saj, nuk lejohet namazi në të. Nëse falet, namazi nuk është i vlefshëm. I Dërguari (alejhi selam) thotë: *“Popujt që ishin para jush i shndërruan varret e Pejgamberëve dhe njerëzve të devotshëm në faltore, juve mos e bëni një gjë të tillë. Unë jua ndaloj këtë vepër.”*³⁷ Kjo do të thotë së namazi në këtë vend është i pavlefshëm.
- d) Nëse varri gjendet në oborrin e xhamisë, i cili është i rrethuar me murin e xhamisë,

³⁷ Transmeton Muslimi (532).

nuk lejohet namazi në të, edhe pse varri nuk është brenda xhamisë, nuk lejohet namazi, sepse oborri merr gjykimin e xhamisë, sikur të jetë pjesë e saj, përderisa njerëzit falen në oborr, nëse nuk falen në të, atëherë varri që gjendet brenda oborrit nuk ndikon në namazin që falet brenda xhamisë.

14. Kush falet në xhami duke e ditur se në të ekziston varr apo falet para ndonjë varri pa asnjë lloj pengese apo vijë ndarëse, në këtë rast ky person duhet ta përsëritë namazin. Në rastin kur nuk ka dijeni për ekzistencën e varrit në atë vend dhe e merr vesh pas përfundimit të namazit, nuk e përsërit namazin, namazi i tij është i saktë.

15. Është e urryer falja e namazit në kishë, nëse në të ka fotografi e statuja. Ky është mendimi i shumicës së juristëve. Umeri³⁸ dhe Ibën Abasi³⁹ (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre) e kanë ndaluar faljen në kishë.

³⁸ Transmeton Buhariu (434).

³⁹ Transmeton Ibën Ebi Shejbeh (4867).

16. Kur në drejtim të Kibles ka ndonjë kryq, më mirë të mos falet namazi, me përjashtim të rastit kur nuk ka mundësi që t'i shmanget kryqit apo mund të dalë koha e namazit.

Dispozitat e bashkimit të namazeve

1. Nijeti për bashkimin e dy namazeve, duke i falur të dy namazet në kohën e namazit të dytë, është kusht: në momentin e hyrjes së kohës së namazit të parë, udhëtari e bën nijet bashkimin e këtij namazi me namazin e radhës në kohën e të dytit. Kjo është më e sigurt.
2. Nijeti për bashkimin e dy namazeve në kohën e namazit të parë nuk është kusht, nëse pas faljes së namazit të parë dëshiron ta bashkojë të dytin, e ka këtë mundësi, sepse nuk ka argument që e kushtëzon bërjen nijet për bashkimin e namazeve në këtë kohë. Ky është mendimi i shumicës së juristëve.
3. Nëse ka hyrë koha e namazit për një udhëtar, që ende gjendet në vendlindjen e tij, e kemi përmendur dhe më herët se, atij nuk i lejohet

shkurtojë namazin, as ta bashkojë me namazin e radhës, vetëm nëse frikësohet nga dalja e kohës së namazit të dytë dhe nuk gjen asnjë mundësi për ta falur atë, atëherë mund t'i bashkojë dy namazet pa i shkurtuar.

4. Lejohet bashkimi i namazeve për udhëtarin pas daljes nga vendlindja pasi ka hyrë koha e namazit, nëse ky namaz është nga ata që bashkohen, siç janë drekë-ikindi dhe aksham-jaci.
5. Koha e bashkimit të dy namazeve është e gjerë. Ajo nis me fillimin e kohës së namazit të parë dhe përfundon me mbarimin e kohës së namazit të dytë. Ndërkaq nuk lejohet të vonohet drëka dhe ikindia, që falen të bashkuar pas ikindisë, deri në kohën kur zverdhët perëndimi (afër kohës së perëndimit të diellit), sikurse nuk lejohet të vonohet falja e akshamit dhe jacisë të bashkuara pas mesnate.
6. Namazet që bashkohen janë dreka me ikindinë dhe akshami me jacinë. Ky bashkim mund të bëhet në kohën e namazit të parë apo të dytë,

në cilëndo kohë të bëhet, bashkimi është i vlefshëm; ndërsa me namazin e sabahut nuk bashkohet asnjë namaz tjetër; edhe bashkimi i ikindisë me akshamin apo i jacisë me sabahun nuk lejohet.

7. Nëse udhëtari e bën nijet bashkimit të dy namazeve në kohën e namazit të dytë, pastaj arrin në vendlindjen e tij dhe koha e namazit të dytë nuk ka hyrë ende, në këtë rast nuk e bashkon namazin e parë me të dytin, porse çdo namaz e fal të plotë në kohën e tij, me konsensusin e dijetarëve.
8. Nëse udhëtari e bën nijet bashkimit të dy namazeve në kohën e namazit të dytë, pastaj arrin në vendin e dëshiruar dhe ka mbetur pak kohë për të hyrë koha e namazit të dytë, në këtë rast ai ka këto mundësi:
 - a) Nëse nuk gjendet në ndonjë xhami, atëherë më mirë për të është të presë derisa të hyjë koha e namazit të dytë dhe t'i falë të dyja të

bashkuara dhe shkurtuara, por edhe nëse falet, i lejohet një gjë e tillë.

b) Nëse ka hyrë në xhami pas thirrjes së ezanit të namazit të dytë dhe para thirrjes së ikametit, atëherë namazin e parë e fal të shkurtuar, pastaj të dytin e fal me xhemat.

c) Nëse ka hyrë në xhami dhe njerëzit janë duke e falur namazin e dytë, atëherë falet me ata me nijetin e namazit të parë, ashtu siç e kemi sqaruar te falja e namazit të udhëtarit pas vendasit.

9. Nëse udhëtari e bën nijet bashkimit të dy namazeve në kohën e namazit të dytë, pastaj arrin në vendlindjen e tij dhe koha e namazit të dytë veçse ka hyrë, në këtë rast e fal namazin e parë dhe të dytë të plotë për shkak të ndërprerjes së udhëtimit.

10. Nëse gjatë kthimit për në vendlindje mendon se mund të arrijë ta falë namazin me xhemat, apo mund ta arrijë ta falë namazin në kohën e vet, apo arrin në vendlindje para se të hyjë ko-

ha e namazit të dytë, në këtë rast atij i lejohet bashkimi dhe shkurtimi i dy namazeve para se të arrijë në vendlindjen e tij, për arsye se ai vazhdon të konsiderohet udhëtar.

11. Udhëtarit i lejohet bashkimi i namazeve përdërisa është duke udhëtuar nga një vend në tjetrin.
12. Dijetarët ndajnë mendime të ndryshme sa i përket bashkimit të dy namazeve për udhëtarin që ka arritur në destinacion. Shumica e dijetarëve mendon se lejohet bashkimi; gjithashtu është thënë se nuk lejohet bashkimi, veçse në rast nevoje. Më mirë është që të mos bashkohen namazet, vetëm nëse has në vështirësi apo në rast nevoje, për arsye se sheriatu islam e ka legjitimuar bashkimin e namazeve për shkak të nevojës e jo për shkak të udhëtimit. Në udhëtim, në rast nevoje, i bashkon namazet.
13. Është obligim që namazet e kaluara, të cilat nuk janë falur të falen sipas radhës, gjithashtu

edhe namazet që dëshirojmë t'i bashkojmë. Ky është mendimi i shumicës së juristëve.

14. Falja e renditur e namazeve nuk është detyrim, kur namazet që falen njëri pas tjetrit të bashkuar bëhen me harresë, ose nuk dihen që renditja është obligim, ose në rastin kur ekziston frika se mund të dalë koha e namazit.
15. Nëse udhëtari kujtohet se ka harruar të falë një namaz të mëparshëm, ndërkohë që është duke falur namazin e radhës në kohën e vet, ai duhet të plotësojë namazin që ka nisur, pastaj të falë namazin që kishte harruar.
16. Rënditja e namazeve mbetet obligim edhe gjatë bashkimit të tyre, edhe nëse ekziston frika e humbjes së xhematit, për arsye se, në këtë rast, renditja është më e rëndësishme sesa falja e namazit me xhemat, duke marrë parasysh faktin se në shumicën e rasteve ekziston xhemat i dytë pas të parit.
17. Në rast të bashkimit të dy namazeve, në kohën e namazit të parë apo të dytë, nuk është kusht

që namazet të falen njëri pas tjetrit. Gjithsesi është prej sunetit që të mos ketë diferencë të gjatë kohore mes faljes së dy namazeve. Duke qenë se kjo çështje është e diskutueshme mes dijetarëve, le të bëjmë më të mirën e mundshme.

18. Kriteri vlerësues, që përcakton nëse koha ndërmjet dy namazeve është shkurtër apo e gjatë, është *urfi* (zakoni apo tradita, gjykimi i njerëzve të atij vendi).
19. Nëse udhëtari e bashkon namazin e akshamit me atë të jaciesë në kohën e akshamit, atij i lejohej që ta falë namazin e vitrit pasi fal jacinë dhe nuk është e nevojshme të presë kohën e jaciesë. Ky është mendimi i shumicës së juristëve.
20. Nëse udhëtari e bashkon namazin e ikindisë me atë të drekës në kohën e drekës, atëherë pasi i fal dy namazet, nuk i lejohej që të falë namaz *nafile* (vullnetar), për arsye se mosleji-

mi i faljes pas ikindisë është i lidhur me vetë namazin të ikindisë e jo me kohën e tij.

21. Nëse njeriu i bashkon dy namazet (i fal njëri pas tjetrit), më mirë është që të bëjë dhikrin pas çdo namazi që fal; nuk është problem nëse e bën dhikrin në fund, pas faljes së dy namaz-eve, ngase lejohet të bëhen bashkë dy dhikret.

22. Namazi në aeroplan mund të ndahet në dy lloje:

a) Namazet *nafile* (vullnetare), të cilat udhëtar i fal në çfarëdo gjendje që të jetë: në këmbë apo ulur, duke bërë me shenjë në momentin e rukusë dhe sexhdes, në çfarëdo drejtimi që fluturon avioni. Mirëpo më e mira është që kur të bëjë tekbirin fillestar (të hyjë në namaz), nëse ka mundësi, të drejtohet nga Kibla.

b) Për namazet *farze* (obligative) kemi disa situata:

- Nëse ka mundësi, më e mira është që t'i falë para se të hipë në aeroplan apo pas

zbritjes prej tij, në kohën e tyre, duke i bashkuar në kohën e parë apo të dytë.

- Kur hipën në aeroplan, para se të hyjë koha e namazit dhe mendon se avioni nuk arrin në destinacion vetëm pasi të përfundojë koha e namazit të parë, në këtë rast e bën nijet bashkimit të tyre në kohën e namazit të dytë, nëse janë dy namaze që mund të bashkohen (drekë-ikindi dhe aksham-jaci).
- Udhëtari e ka për detyrë ta falë namazin në avion në vendfalje (mundësisht në drejtim të Kiblës), nëse hipën në të para se të hyjë koha e namazit dhe mendon se ka mundësi se mund t'i humbasë të dy namazet që mund të bashkohen apo edhe një namaz që nuk bashkohet, siç është sabahu. Ndërsa nëse nuk ekziston vendfalje në avion, ai falet në korridor; nëse nuk mundet, atëherë e fal ulur në vendi i tij, duke bërë me shenjë në mo-

mentin e rukusë dhe sexhdes. Nuk lejo-
het që t'i vonojë namazet deri në përfun-
dim të kohës së tyre. Nëse nuk ka mun-
dësi ta falë namazin në këmbë, atëherë e
fal atë ulur.

- Nëse në aeroplan ka vendfalje dhe mu-
nd të falet në drejtim të Kibles duke që-
ndruar në këmbë dhe duke e bërë ruku-
në dhe sexhden ashtu si duhet, atëherë
falet në të. Nëse nuk mundet të falet më
këmbë, atëherë falet ulur në ndenjësën e
tij.

23. Është e domosdoshme që udhëtari të drejtoh-
et nga kibla në momentin e tekbitit fillestar
(kur hyn në namaz), pastaj e vazhdon namaz-
in në çdo drejtim që merr avioni; nëse nuk ka
mundësi, nuk i bëhet obligim drejtimi nga Ki-
bla.

24. Kur, gjatë fluturimit, avioni ndryshon drejtim-
in, duke devijuar nga Kibla, nëse udhëtari ka
mundësi ta ndjekë apo ta kërkojë drejtimin e

Kibles, duhet ta bëjë këtë gjë; nëse nuk ka mundësi, atëherë falet në ndenjësën e tij dhe bie kushti i faljes në drejtim të Kiblës për shkak të pamundësisë.

25. Lejohet që udhëtari në makinë të falë namaz nafle kur arrin në vendin e dëshiruar, nëse është në drejtim të Kibles. Falja në drejtim të Kiblës është obligim njëloj si për rezidentin, dhe kjo me konsensus të dijetarëve. Ky është mendimi i shumicës së juristëve, bazuar në Traditën e të Dërguarit (alejhi selam).

26. Lejohet që udhëtari të falet në makinë, nëse udhëton nga një vend në tjetrin.

Momente nga jeta e dijetarëve (Allahu i mëshiroftë) si e shfrytëzonin ata kohën gjatë udhëtimeve

Ibën Haxheri e shkroi librin e tij *“En-Nuhbetu”* në udhëtim. Po ashtu edhe Ibën Kajimii shkroi duke qenë në udhëtim librat: *“Zad el-mead”*, *“Mif-*

tah dar es-seadeh”, *“Bedai’ el-fevaid”* dhe *“Raudat el-muhibine”*.

Drejtori i zyrës së Ibën Bazit tregon: “Duke shoqëruar shejhun nga Taifi për në Riad me aeroplan, i lexova dyqind faqe nga libri *“Ia’lamu el-muvaki’in”*. Gjithashtu nga aeroporti deri në shtëpinë e tij i lexova një raport prej shtatëmbëdhjetë faqesh për gjendjen e davetit (thirrjes në fenë e Allahut) në disa shtete të botës. Kur përfundoi udhëtimi ai më tha: “Kur shpirti kënaqet, trupi nuk e ndjen lodhjen.”

Bamirësit në udhëtimet e tyre

Bamirësit e venë në rrezik veten, shpenzojnë tërë pasurinë, braktisin vendlindjen, familjen e fëmijët, me ditë, javë e muaj, vetëm e vetëm që t’ua mësojnë njerëzve fenë e Allahut. Ata bëjnë *davet* (e kryejnë misionin e thirrjes në fe), e përhapin mirësinë përmes mesazhit islam në gjithë botën, madje dhe në xhunglat e Afrikës, në malet e Kaukazit, në vendet e Baltikut e të Ballkanit, në

Filipine, në Indonezi, në malet e Indisë dhe përtej ishujve kinezë.

Ata janë bamirës me moralin, me fjalët dhe veprat e tyre; janë bamirës ndaj familjarëve dhe shoqëruesve të tyre në udhëtime; janë bamirës duke plotësuar nevojat e njerëzve dhe ndihmuar të varfrit, të sëmurët, të pastrehët, si dhe duke orientuar devijuarit dhe të humburit.

Bëhu i tillë, sepse Allahu i do bamirësit. Sa e bukur është bamirësia dhe sa të moralshëm e të virtytshëm janë bamirësit!

Dispozitat e ditës së xhuma

1. Lejohet udhëtimi në ditën e xhuma, para se të hyjë koha e namazit. Pas hyrjes së kohës së namazit nuk lejohet udhëtimi. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam. Xhumaja është në kohën e drekës.

Në disa raste lejohet udhëtimi në ditën e xhuma, edhe pasi ka hyrë koha e saj:

- nëse udhëtari frikësohet se mos i ikin shokët;
- nëse i mundësohet që ta falë gjatë rrugës;
- nëse xhumaja përkon me ditën e Bajramit dhe e ka falur namazin e Bajramit, atëherë nuk e ka obligim namazin e xhumasë.

2. Namazi i xhumasë në udhëtim mund të kategorizohet në pesë raste:

- a) Nëse është duke udhëtuar, nuk i obligohet namazi. Është thënë se për këtë ka *ixhma* (konsensus të dijetarëve).
- b) Udhëtari nuk obligohet ta falë xhumanë nëse është në udhëtim e sipër, kalon pranë ndonjë vendbanimi dhe ndalet për të plotësuar nevojat e veta, e pastaj e dëgjon ezanin e namazit të xhumasë.
- c) Nëse zbret në një vend ku falet namazi i xhumasë dhe e dëgjon ezanin, a i behet obligim falja e namazit të xhumasë?

Një pjesë e dijetarëve thonë se obligohet ta falë xhumanë, ndërsa pjesa tjetër thotë nuk

obligohet. Mirëpo më e mira është që të mos lihet namazi i xhumasë, në kërkim të shpërblimit dhe për të bërë më të mirën e mundshme.

d) Nëse zbret në një vend ku nuk falet namazi i xhumasë dhe nuk dëgjohet ezani i këtij namazi - sikurse ai që ka dalë për piknik jashtë vendbanimit - nuk e ka obligim namazin e xhumasë.

e) Ata që jetojnë në vendet jomyslimane obligohen ta falin namazin e xhumasë, sepse argumentet e përgjithshme e pohojnë një gjë të tillë dhe se ata e kanë për detyrë xhumanë përderisa jetojnë në ato vende.

3. Pëlqehet lutja në kohën e fundit të ditës së xhuma. Udhëtimi dhe xhumaja janë dy shkaqe e favorizojnë udhëtarin për pranimin e lutjes.

4. Udhëtari që falet me njerëz që e falin namazin e xhumasë ka mundësi të zgjedhë njërën prej dy mundësive:

- a) ose të bëjë nijetin për faljen e xhumasë dhe kjo është më e mira, sepse fiton shpërblimin e xhumasë dhe del nga mospajtimet;
 - b) ose të bëjë nijetin për namazin e drekës dhe pas namazit të çohet dhe të falë dy rekate të tjera, ngase është falur pas vendasit dhe duhet ta falë drekën e plotë.
5. Nuk u konsiderohet e vlefshme xhumaja e atyre udhëtarëve që e falin me grupin e tyre në ndonjë vend ku nuk falet xhumaja. Ata e kanë obligim të falin namazin e drekës.
6. Udhëtarit, që gjendet në namazin e xhumasë dhe gjatë hutbes dëshiron të dalë prej xhamisë, i lejohet ky veprim, sepse ai nuk e ka detyrë xhumanë.
7. Lejohet që udhëtari t'u prijë njerëzve në namazin e xhumasë. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam.
8. Sa i përket tauafit përreth Qabesë, në kohën kur imami mban hutben e xhumasë, ka dy raste:

- a) nëse është në udhëtim e sipër duke kaluar nga Meka dhe dëshiron të hyjë në Xhaminë e Shenjtë (në Qabe) për të bërë tauaf në kohën kur është duke u zhvilluar hutbeja e xhumasë, atij i lejohet të bëjë tauaf, sepse nuk e ka obligim namazin exhumasë;
 - b) nëse është ndalur për të qëndruar në Mekë, atëherë më mirë është të mos bëjë tauaf gjatë hutbes, sepse argumentet e përgjithshme pohojnë se është detyrë heshtja në kohën kur mbahet hutbeja. Kjo ndalesë vlen edhe për tauafin gjatë të cilit bëhet dhikër dhe dhikri bëhet përmes artikulimit të fjalëve.
9. Më e mirë e më e sigurt është që të mos bashkohet namazi i ikindisë me namazin e xhumasë duke i qëndruar besnik njëres prej dispozitave themelore të namazit, që konsiston në ndalimin e bashkimit të namazeve, përveç rasteve të parashikuara nga sheriatu dhe për këtë rast nuk ka argument, njëkohësisht shmangen edhe

mosmarrëveshjet mes dijetarëve lidhur me këtë çështje.

10. Udhëtari nuk e ka detyrë namazin e xhumasë - si në rastin kur është në udhëtim e sipër, ose ka udhëtuar para hyrjes së kohës, apo gjendet në një vend ku nuk falet xhumaja - në të gjitha këto raste atij i lejohet ta falë drekën dhe ikin-dinë të shkurtuara dhe të bashkuara.
11. Nëse udhëtari arrin prej namazit të xhumasë më pak se një rekat, atëherë obligohet të plotësojë katër rekate.
12. Nëse udhëtari hyn në qytetin e tij në ditën e xhuma dhe ka mbetur pak kohë për të falur namazin, obligohet që ta falë atë menjëherë.
13. Nëse udhëtari e ka falur drekën në ditën e xhuma, pastaj ka hyrë në qytetin e tij dhe ka mundësi të arrijë namazin e xhumasë, atëherë ai nuk e ka detyrë që ta falë atë (namazin e xhumasë).
14. Nëse njeriu udhëton ditën e xhuma pasi hyn koha e namazit të xhumasë dhe gjen xhami ku

falet xhumaja, atëherë ai e ka detyrë të falet me ta; nëse nuk gjen, atëherë duhet të bëjë istigfar (t'i kërkojë falje Allahut) dhe duhet ta falë atë si namaz dreke me dy rekate, pra të shkurtuar.

15. Preferohet që udhëtari të lexojë sure El-Kehf në ditën e xhuma.
16. Udhëtari që nuk e ka detyrë namazin e xhumasë, nuk e ka detyrë as *gusulin* (larjen e plotë të trupit) në ditën e xhuma, ngase *gusuli* në këtë ditë është detyrë për atë që e ka obligim xhumanë.
17. Udhëtari që e fal namazin e xhumasë, i fal gjithashtu edhe sunetet e xhumasë, ngase ato kanë lidhje me xhumanë.
18. Raportet e udhëtarit me shitblerjen pas ezanit të dytë në ditën e xhuma mund të paraqiten në dy raste:
 - a) nëse edhe shitësi, edhe blerësi janë udhëtarë, atëherë atyre u lejohet shitblerja, sepse nuk e kanë obligim xhumanë.

- b) nëse njëri është udhëtar e tjetri vendas, për vendasin ndalohet shitblerja, ndërsa për udhëtarin nuk preferohet, që ky i dyti të mos e ndihmojë të parin në mëkate.

Dispozitat e Bajramit

Dispozitat e namazit të Bajramit janë si vijon:

1. Për udhëtarin që është në udhëtim e sipër nuk është detyrë namazi i Bajramit.
2. Për udhëtarin që ndalet në një vend ku falet namazi i Bajramit dijetarët ndajnë mendime të ndryshme:
 - a) falja e namazin e Bajramit është detyrë;
 - b) falja e namazin e Bajramit nuk është detyrë; ky është mendimi i shumicës së juristëve islam. Më e mira është që të falet namazi i Bajramit në kërkim të shpërblimit dhe për të shmangur mosmarrëveshjet mes dijetarëve lidhur me këtë çështje.
3. Udhëtari që zbret në një vend ku nuk falet namazi i Bajramit nuk e ka për detyrë atë.

4. Muslimanët që jetojnë në vendet jomuslimane obligohen ta falin namazin e Bajramit.

Dispozitat e zekatit

1. Kush është udhëtar dhe i bëhet obligim zekati, jep atë nëse posedon me vete pasuri. Nëse nuk posedon, atëherë e vonon derisa të kthehet në vendin e vet nëse udhëtimi është i shkurtër, ose porosit dikë që ta japë në vendin e vet.
2. Kujt i bëhet obligim zekati i Fitrit dhe është udhëtar, e jep në atë vend ku është, ndërsa familjarët e tjerë e japin vetë në vendin e tyre. Lejohet që udhëtari të autorizojë familjarët që ta japin zekatin në vend të tij, mirëpo më e mirë është të veprohet e para.
3. Nuk jepet zekati për atë që humbet në udhëtim dhe nuk dihet gjë për gjendjen e tij; nëse pastaj merret vesh që është gjallë, obligohet kompensimi për atë që ka kaluar; nëse zhduket për një kohë të shkurtër dhe mbizotëron mendimi se ai është gjallë, për të jepet zekati.

4. Nëse ndonjë pjesëtar i familjes, përveç bashkëshortes, udhëton për shkak të studimeve ose për ndonjë vizite e kështu me radhë, a duhet që ai ta japë vetë zekatin e Fitrit, apo e japin prindi për të? Ka dy raste:
- a) nëse nuk është i varur financiarisht nga prindi, e jep vetë në vendin ku jeton; e nëse prindi e jep për të në vendin e tij, edhe kjo lejohet, edhe pse më e mira është të veprohet e para;
 - b) nëse është i pavarur financiarisht, e jep vetë në atë vend ku është duke qëndruar.
5. Nëse muslimani është udhëtar në një shtet ku nuk njeh ndonjë të varfër që e meriton zekatin e Fitrit, atëherë autorizon dikë tjetër në vendin e tij që ta nxjerrë për të.

Dispozitat e agjërimit

1. Është e lejuar lënia e agjërimit në udhëtim në rast se e ka të vështirë atë. Gjithashtu lejohet agjërimi në qoftë se nuk ndien vështirësi. Mirë-

po më e mira është që të agjërohet nëse nuk ndien vështirësi dhe ky është mendimi i shumicës së juristëve islam, veçanërisht ai që udhëton për në Mekë nuk duhet ta humbasë shpërblimin e shumëfishuar.

2. Më mirë për udhëtarin është që të mos agjërojë ditën e Ashuras dhe të Arafatit, nëse agjërimi për të është shumë i vështirë. Në qoftë se vështirësia durohet ose nuk ka ndonjë vështirësi të madhe, atëherë është mirë të agjërojë, për shkak se këto ditë janë të pazëvendësueshme.
3. Kur personi vendos të udhëtojë, nuk i lejohet që ta prishë agjërimin, vetëm pasi t'i ketë kaluar vendbanimet e fundit të qytetit të tij.
4. Udhëtarit agjëruar i lejohet prishja e agjërit, qoftë gjatë rrugëtimit apo pasi të ketë arritur në vendin e dëshiruar; kjo është e transmetuar nga Profeti (sala Allahu alejhi ue selem).⁴⁰
5. Kush agjëron duke qenë në udhëtim dhe i ndodh që të ketë pasur marrëdhënie intime me

⁴⁰ Transmetojnë Buhariu (1948), Muslimi (1113).

gruan e tij, duke mos e bërë nijet prishjen e agjërimit apo para se të ketë ngrënë, në këtë rast, vepra e tij lejohet dhe nuk ka *kefare*t (dëmshpërblim) për të.

6. Nëse ka pasur marrëdhënie intime me gruan e tij duke qenë në vendin e tij, pastaj niset në udhëtim, e ka obligim *kefare*tin për të shlyer këtë gjynah të madh që ka bërë duke kryer marrëdhënie intime gjatë ditës së Ramazanit. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam.
7. Nëse udhëtari, që nuk agjëron, arrin në vendin e tij, nuk obligohet të agjërojë pjesën e mbetur të asaj dite, mirëpo nuk bie në sy njerëzve të mos krijohen keqkuptime ndaj tij. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam.
8. Nëse udhëtari bën nijetin për të agjëruar dhe hyn në qytetin e tij agjërueshëm, atëherë atij nuk i lejohet ta prishë agjërimin. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam.
9. Prishja e agjërit gjatë udhëtimit nuk shihet si ndërprerje e vazhdueshmërisë së tij, si në rastin

e dëmshpërblimit për vrasjen e paqëllimtë dhe të marrëdhënieve intime gjatë ditës së Ramazanit (pasi për këto dytë fundit kompensimi me agjërim duhet të bëhet pa ndërprerje, por në rastin e udhëtarit nuk ka problem).

10. Atë që e zë perëndimi i diellit në aeroportin e shtetit të tij apo në ndonjë shtet tjetër dhe ka çelur iftarin, e pastaj, pasi të ketë hipur në aeroplan, e sheh diellin, nuk e ka obligim ta vazhdojë agjërimin.
11. Nëse hipën në aeroplan pak minuta para se të ketë perënduar dielli dhe duke qenë lart në horizont dita vazhdon, atëherë ai nuk e prish agjërimin dhe nuk e fal namazin e akshamit derisa të ketë perënduar dielli në hapësirën ajrore në të cilën gjendet.
12. Kush dëshiron të udhëtojë, ka rezervim të sigurt, aeroporti është jashtë qytetit të tij, ai e ka prishur agjërimin dhe e ka shkurtuar namazin pasi ka ketë dalë nga qyteti i tij, pastaj është vonuar aeroplani apo del i ndonjë pengesë që

nuk ia mundëson udhëtimin në atë ditë, atëherë, në këtë rast, namazi i tij është i saktë, po ashtu dhe agjërimi; nuk i obligohet që ta vazhdojë agjërimin.

13. Sa i përket shikimit të hënës për fillimin dhe përfundimin e agjërit në Ramazan, udhëtari mund të gjendet përballë njërit prej këtyre katër rasteve:

- a) kush udhëton në fundin e muajit Shaban prej një shteti, në të cilin ende nuk e kanë filluar agjërimin, kurse te shteti drejt së cilit udhëton e kanë parë hënën dhe agjërojnë, atëherë ai duhet të agjërojë bashkë me ta;
- b) kush udhëton prej një shteti ku banorët e të cilit e kanë parë hënën që sinjalizon hyrjen e muajit Sheual dhe ai mbërrin në vendin e tij, ku nuk e kanë parë hënën e Sheualit, atëherë ai nuk agjëron për shkak se e ka ndërprerë agjërimin dhe më pas e kompenson atë që i ka mbetur prej agjërit;

- c) kush udhëton prej një vendi, banorët e të cilit agjërojnë dhe arrin në vendin e tij, banorët e të cilit nuk agjërojnë, atëherë ai obligohet të agjërojë, në qoftë se nuk i ka plotësuar 30 ditë; përndryshe jo, sepse nuk lejohet të agjërojë 31 ditë; dihet se muaji i agjërimit plotësohet më 30 ditë.
- ç) kush udhëton nga vendi i tij duke mos qenë agjërueshëm, teksa njerëzit janë duke agjëruar ditën e tridhjetë, kurse në vendin e mbërritjes ka Bajram, atëherë ai obligohet ta kompensojë atë ditë;
- d) kush agjëron në një vend dhe e ndërpret agjërimin bashkë me banorët e atij vendi për shkak të Bajramit duke qenë se ai ka agjëruar 29 ditë, pastaj kthehet në vendin e tij; në këtë rast ka disa mundësi:
- kur banorët e vendit të tij dhe të vendit tek i cili ka udhëtuar kanë agjëruar 29 ditë, atëherë ai mjaftohet me 29 ditët që ka agjëruar;

- kur banorët e vendit ku ai e përfundoi agjërimin dhe festoi bashkë me ta Bajramin agjëruan 29 ditë, kurse banorët e vendit i tij agjëruan 30 ditë, pa marrë parasysh se në vendin e tij ka agjëruar apo jo ndonjë ditë, atëherë atij i mjaftojnë 29 ditë, duke marrë parasysh faktin që festoi Bajramin në vendin që agjëroi 29 ditë;
- banorët e dy vendeve kanë agjëruar nga 30 ditë, mirëpo ky udhëtar ka agjëruar 29 ditë, ngase e festoi Bajramin në vendin tek i cili udhëtoi, që do të thotë se vendi i tij e kishte filluar agjërimin një ditë më vonë; më e mira, në këtë rast, është t'i plotësojë 30 ditë.

14. Nëse banorët e vendit të tij e fillojnë agjërimin, ndërkaq në ditën e parë të agjërimin ai udhëton drejt një vendi banorët e cilit nuk e kanë filluar agjërimin; në këto kushte kur ai ka vendosur të banojë në këtë vend, për të ka disa raste:

- a) kur ai ka vendosur të banojë vendin tek i cili ka udhëtuar dhe arrin të festojë Bajramin aty, teksa ka agjëruar 29 ditë, në këtë rast e kompenson ditën e parë të Ramazanit që i ka mbetur;
- b) kur ai ka vendosur të banojë në vendin tek i cili ka udhëtuar dhe arrin të festojë Bajramin me ta, teksa ka agjëruar 30, ndërsa i ka mbetur pa agjëruar dita e parë: a ta agjërojë atë ditë që i bie të ketë agjëruar 31 ditë, apo të mos e agjërojë atë ditë, sepse muaji i agjërimit është 30 ditë?

Kjo çështje ka nevojë për meditim, edhe pse më e mira është që ta kompensojë.

15. Udhëtimi për në xhami për shkak të itikafit ka disa raste:

- a) Nëse udhëtohet për te dy xhamitë e shenjta (Mekë dhe Medine) dhe Xhaminë Aksa (në Palestinë), atëherë udhëtimi lejohet.
- b) kur bëhet fjalë për në vende të tjera, jo në tre xhamitë e lartpërmendura, shihet se për

çfarë qëllimi udhëton: a udhëton për shkak të vetë xhamisë, si objekt, apo për shkak se në të ndihet rehat, më i përkushtuar e i përlurur ndaj Allahut, imami lexon bukur dhe atje ka mësim e ligjërata etj. Në rastin e parë nuk lejohet, në të dytin po.

Disa dispozita rreth vizitës së Mekës dhe Qabesë së Shenjtë

1. Jomyslimanit nuk lejohet që të hyjë në Mekë, në kufijtë e Kryeqytetit të Shenjtë, sepse Allahu i Lartësuar thotë: *“Në të vërtetë, idhujtarë janë të papastër (për shkak të besimit të kotë), prandaj të mos i afrohen Xhamisë së Shenjtë.”*⁴¹
2. Lejohet hyrja në Mekë pa e bërë umren, sikurse lejohet të hyjë në të vetëm për të bërë tauaf apo që të falur namazin.
3. Namazi i përsëritjes së xhamisë në Qabe është dy rekate, mirëpo i lejohet t’ia fillojë me tauafin (para se falë dy rekatet). Pastaj ai fal dy

⁴¹ Kurani, Et-Teube: 28.

rekate të tauafit dhe kjo konsiderohet përshëndetje e xhamisë.

4. Namazit në Mekë- brenda kufijve të Kryeqytetit të Shenjtë - i shumëfishohet shpërblimi, dhe është sa 100.000 namaze (që falen xhami në vende të tjera). Këtë shpërblim e merr pavarësisht se është namaz *farz* (obligativ) apo *nafile* (vullnetar). Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam. Sa u përket adhurimeve të tjera të ndryshme, shpërblehen shumëfish, mirëpo shpërblimi nuk është i përcaktuar.
5. Tavafi i lamtumirës nuk është obligim për vizitorin e Mekës kur dëshiron të dalë prej saj, sepse nuk ka argument që e obligon atë, ndërsa haxhiu obligohet që ta bëjë tauafin e lamtumirës para se të largohet nga Meka.
6. Në Mekë nuk lejohet gjuetia, as prerja e pemëve që kanë mbirë vetvetiu, pa qenë shkaktar njeriu. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam. Kjo ndalesë nuk është për pemët të

cilave u hahen frytet, as për misvakut apo për ato medikamentet prej të cilave ka dobi.

Disa dispozita të haxhit dhe të umres⁴²

1. Mënyra se si udhëtari parapërgatitet dhe bën nijetin që të hyjë në adhurimin e haxhit apo umres në aeroplan:
 - a) lahet në shtëpinë e tij dhe rri me rrobat që vesh në jetën e përditshme, mirëpo nëse do, e vesh ihramin në shtëpi;
 - b) kur të afrohet aeroplani paralelisht me *mikatin* (vendi ku bëhet nijeti për të hyrë në adhurimin e umres dhe të haxhit), e vesh ihramin nëse nuk e ka veshur më parë;
 - c) kur aeroplani arrin paralelisht me *mikatin*, bën nijetin për hyrje në ritualet e umres dhe të haxhit;
 - ç) nëse e vesh ihramin para se aeroplani të arrijë paralelisht me mikatin nga frika e shkuj-

⁴² Për më shumë lexo librin tim “*Et-Tuhfetu fi ahkamil umreti*”, botimi i shtatë, nga shtëpia botuese “*Daru el-hadarah*”.

desjes apo harresës, i lejohet kjo gjë. Ky është mendimi i katër imamëve.

2. Kush zbret në aeroportin e Xhidës me nijetin për haxh ose umre dhe nuk e ka veshur ihramin në aeroplan në momentin kur ai ka qenë paralelisht me mikatin, atëherë në këtë rast personi obligohet që të kthehet te mikati i shtetit të vet, e vesh ihramin dhe e bën nijetin atje. Nëse nuk ka mundësi të bëjë një gjë të tillë, atëherë e vesh ihramin dhe e bën nijetin në Xhidae dhe gabimin e kompenson me *fidje* (dëmshpërblim): ther një dele në Mekë dhe mishin e saj ua shpërndan të varfërve të atij vendi. Ky është mendimi i katër imamëve.
3. Udhëtari që udhëton me aeroplan me nijet për haxh apo umre, kur ka kaluar aeroplani mbi *mikat* ka harruar të veshë ihramin, në këtë rast ai duhet ta heqë rrobën e sipërme, duhet ta bëjë si ihram e të mbështillet me të, ndërsa pantallonat e mban veshur derisa të zbresë. Nëse kjo gjë është e vështirë për të, ai qëndron në

rrobat që ka veshur dhe paguan fidje për rrobat e qepura. Nëse ka mbuluar kokën, paguan fidje edhe për mbulimin e kokës. Ai duhet të shpejtojë që ta veshë ihramin sa më parë.

4. Udhëtari që dëshiron të bëjë umren dhe haxhin, ndërkaq gjatë kalimit mbi mikat e ka zënë gjumi dhe e nuk e ka bërë nijetin për të hyrë në adhurimin e umres dhe të haxhit, në këtë rast, duhet të kthehet te mikati dhe ta bëjë nijetin atje. Gjithë dijetarët kanë rënë në konsensus për këtë. Nëse nuk mundet, atëherë del jashtë kufijve të Mekës, por duhet të therë një dele dhe t'ua shpërndajë të varfërve. Kush e bën nijetin për adhurimin e haxhit para se të arrijë aeroplani paralelisht me mikatin, e zë gjumi dhe pastaj zgjohet pasi të ketë kaluar mikatin, në këtë rast nijeti i tij është i saktë, ai ka hyrë në adhurimin e haxhit.
5. Edhe ai që udhëton me anije duhet të bëjë nijetin dhe të hyjë në adhurimin e umres dhe të haxhit kur arrin paralelisht me mikatin, mi-

rëpo nëse nuk mundet ta bëjë një gjë e tillë duke udhëtuar në det, e bën atë në Xhide.

6. Kush hyn në Mekë me ihram, nuk obligohet të shpejtojë për ta kryer menjëherë umrën.
7. Kush udhëton nga vendlindja për arsye të ndryshme dhe kalon pranë mikatit mund të gjendet para këtyre situatave:
 - a) nëse nuk ka bërë nijet për umre apo haxh, atëherë nuk detyrohet për asgjë;
 - b) nëse nuk e di se a do i mundësohet umra apo haxhi, atëherë nuk është detyrë për të që të hyjë në këto adhurime prej mikatit. Nëse e bën nijetin më vonë, atëherë ai vesh ihramin dhe hyn adhurimin e haxhit apo të umres në vendin ku gjendet. Kur këtë vendim e merr brenda territorit të Mekës, atëherë del jashtë kufijve të saj, e vesh ihramin dhe hyn në adhurimin e umres dhe të haxhit. Nëse vendos jashtë Mekës dhe pa arritur te ndonjë prej mikateve, si p.sh. në Xhide

apo Bahra, atëherë e bën nijetin nga vendi ku gjendet;

- c) nëse kalon te mikati dhe ka vendosur për haxh apo umre -para ose pasi të ketë kryer punën e vet- mirëpo nuk e ka veshur ihramin dhe nuk ka hyrë në këto ibadete, në këtë rast obligohet të kthehet te mikati, nëse dëshiron haxh apo umre. Nëse nuk mundet, atëherë vesh ihramin dhe hyn në këto ibadete prej vendit ku gjendet dhe paguan *fidje* (bën kurban një dele në Mekë dhe ua mishin shpërndan të varfërve atje). Nëse gjendet në Mekë, atëherë del jashtë kufijve dhe pastaj paguan *fidje*.

8. Gruaja me menstruacione që kalon nga mikati mund të përballet me tre situata:

- a) nëse mendon që do pastrohet gjatë kohës që qëndron në Mekë, atëherë bën nijet për ta kryer adhurimin, hyn në Mekë dhe pret derisa të pastrohet; pasi pastrohet e bën umren;

- b) nëse nuk e di a do pastrohet apo jo gjatë qëndrimit në Mekë, atëherë bën nijet për ta kryer adhurimin dhe e kushtëzon duke thënë: *“Allahumme lebbejke umreten, fe in habe-seni haabisun fe mehil-li hajthu habesteni - O Zoti im, të përgjigjem për umre. Nëse më del ndonjë pengesë, atëherë unë do ta ndërpres ibadetin në momentin që më del pengesa.”* Nëse pastrohet, atëherë e plotëson umren; nëse dëshiron të dalë nga Meka pa u pastruar ende, lejohet të dalë pa bërë umre pa problem;
- c) nëse gruaja me menstruacione kalon pranë mikatit dhe nga padija nuk hyn në adhurim, mirëpo e ka pasur nijetin në zemër, pastaj pastrohet në Mekë dhe dëshiron të bëjë umren, në këtë rast ajo kthehet te mikati i shtetit të saj; nëse nuk mundet, atëherë del jashtë kufirit të Mekës, hyn në adhurim, e kryen umren dhe bën kurban një dele për të varfrit e Mekës.

9. Gruaja në ciklin mujor lejohet që të bëjë nijetin për umren e të hyjë në adhurim dhe nuk ka argument që ta ndalojë këtë gjë.
10. Udhëtari që dëshiron të bëjë kurban duhet ta bëjë atë në vendin ku është ose ia ngarkon kurbanin një tjetri në vendin e tij apo në ndonjë vend tjetër.

Dispozitat e vizitës së Xhamisë së Profetit (sala Allahu alejhi ue selem)

1. Udhëtimi për të vizituar Xhaminë e Profetit (sala Allahu alejhi ue selem) në çdo kohë është *mustehab* (e pëlqyer) me konsensusin e juristëve islam.
2. Gjikimi për udhëtimin që bëhet me qëllim vizitën e varreve, e posaçërisht për varrin e Profetit (sala Allahu alejhi ue selem):
 - a) nuk lejohet që udhëtari të këtë për qëllim vetëm vizitën e varrit të Profetit (sala Allahu alejhi ue selem), sepse ai (alejhi salatu ue

selam) thotë: *“Ndalohet udhëtimi i qëllimtë, përveç se në tre xhamitë.”*⁴³

- b) nëse udhëtari bën nijet që njëkohësisht të vizitojë xhaminë dhe varrin të Profetit (alejhi selam), atëherë shikohet se kush është primare në nijetin e tij: xhamia apo varri? Kur arrin në Medinë, nëse viziton xhaminë dhe pastaj viziton varrin, kjo është e lejuar; mirëpo nëse ky udhëtim bëhet për shkak të varrit dhe xhamisë, atëherë kjo nuk lejohet.

3. Hadithe të pasakta:

- *“Kush viziton Qabenë dhe nuk më viziton mua, pa dyshim që më ka nënvlerësuar.”*
- *“Shefatin (ndërmjetësimin) tim e meriton ai që viziton varrin tim.”*

Dijetarët e hadithit thonë se çdo gjë që ka ardhur në këtë temë është trillim; kurrsesi nuk është thënë nga goja e Profetit (sala Allahu alejhi ue selem).

⁴³ Transmetojnë Buhariu (1189) dhe Muslimi (1397).

4. Nuk është kusht të qëndrohet në Medinë aq kohë sa të falen dyzet namaze; nuk është i vërtetë besimi i disave se pa falur dyzet namaze në Xhaminë e Profetit (sala Allahu alejhi ue sel-em) nuk pranohet vizita apo se ajo nuk është e plotë.
5. Namazi nafile te *Reuda* (Kopshti i Xhenetit që ndodhet në Xhaminë e Profetit) është i pëlqyer, ndërsa namazi farz në rreshtin e parë është më me vlerë.
6. Kur udhëtari arrin në Xhaminë e Profetit (alejhi selatu ue selem), është e pëlqyer që të vizitojë dhe t'i japë selam Profetit (sala Allahu alejhi ue selem), Ebu Bekrit dhe Omerit (radi Allahu anhum). Pasi i përshëndet, nuk qëndron gjatë; gjithashtu nuk e ngre zërin dhe nuk e përsërit *selamin* (përshëndetjen). Gjithashtu nuk lejohet të lutet te varri (ngado që të drejtohet: nga Kibla apo nga varri) për vete ose për të tjerët, duke besuar se ai është vend i bekuar ku pranohen lutjet. Nuk lejohet t'i lutesh Profetit

(sala Allahu alejhi ue selem) apo të kërkohej prej tij (sala Allahu alejhi ue selem) që të lutet për të, apo të preket varri për bereqet.

7. Grave nuk u lejohet të vizitojnë varrezat, sepse Profeti (sala Allahu alejhi ue selem i ka mallkuar vizitoret e varreve.⁴⁴ Nëse gruaja kalon pranë varrezave, pa pasur qëllim vizitën e tyre, atëherë nuk ka problem nëse u jep selam atyre. Ky është mendimi më i saktë i dijetarëve.
8. A lejohet që vizitori të shkojë te varri i Profetit (sala Allahu alejhi ue selem)sa herë që hyn te xhamia e tij (alejhi salatu ue selam)? Kemi dy gjykime për dy raste të ndryshme:
 - a) Nuk lejohet që vizitori të shkojë qëllimisht te varri i Profetit (sala Allahu alejhi ue selem) sa herë që hyn te xhamia e tij (alejhi salatu ue selam). Këtë gjë nuk e kanë praktikuar sahabët dhe tabiinët; nëse kjo do ishte e ligjëruar, atëherë ata do e kishin bërë.

⁴⁴ Transmeton Tirmidhiu (1056) dhe thotë se hadithi është *hasen* (i mirë).

- b) Jo vetëm që lejohet, por është dhe e pëlqyer përshëndetja e të Dërguarit të Allahut (sala Allahu alejhi ue selem) kur vizitori hyn në xhami.⁴⁵
 - c) Udhëtarit apo vendasit i lejohet të vizitojë varrin kur hyn në Medinë dhe shkon te Xhamia e Profetit (sala Allahu alejhi ue selem).
 - ç) Kurdo të dalë prej Medinës dhe vjen te varri i Profetit (sala Allahu alejhi ue selem) për t'i dhënë selam, nëse e ka për qëllim t'i japë përshëndetjen e lamtumirës, atëherë kjo është çështje adhurimi dhe për këtë duhet argument dhe një i tillë nuk ekziston. Lejohet kur ka për qëllim thjesht përshëndetjen.
9. Vizita e varrezave të Baki'es (varrezat e qytetit të Medines) dhe e shehidëve të Uhudit është

⁴⁵ Nesaiu në librin "*Amelul jeumi uel-lejleti*" (90), gjithashtu e ka saktësuar Busiriu në librin "*Misbah ez-zuxhaxheh*" (1/97) dhe Albani në "*Sahih el-kelim et-tajib*".

pëlqyer, sepse Profeti (sala Allahu alejhi ue selem) e ka bërë një gjë të tillë.⁴⁶

10. Vizita e xhamisë të Kubasë dhe namazi në të është vepër e pëlqyer⁴⁷ dhe ka shpërblimin e umres, siç është transmetuar nga Profeti (sala Allahu alejhi ue selem).⁴⁸

11. A lejohet të falen dy rekatet te xhamia e Kubasë në kohët kur namazi ndalohet?

Kjo është çështje e diskutueshme që i përmban të dyja mundësitë (lejimin dhe ndalimin). Është transmetuar se Ibën Omeri, në udhëtim, nuk e falte namazin e duhasë vetëm nëse vizitonte Mekën ose xhaminë e Kubasë. Çdo të shtunë shkonte te xhamia e Kubasë; nuk dilte xhamia pa u falur në të dhe thoshte: “*Jam duke vepruar ashtu si shokët e mi dhe nuk e ndaloj as-*

⁴⁶ Muslimi (974).

⁴⁷ Buhariu (1194).

⁴⁸ Transmeton Tirmidhiu (324) dhe ka thënë se është hadith *hasen* (i mirë dhe i vërtetë), si dhe Hakimi (4279), i cili e ka saktësuar dhe e ka miratuar Imam Dhehebiu, po ashtu e ka saktësuar atë Iraku në “*Tahrixhul ihja*” (1191, 1192).

*kënd të falet në çfarëdo kohe që dëshiron, gjatë natës apo ditës. Gjithsesi unë jam i kujdesshëm të mos falem në kohën e lindjes dhe perëndimit të diellit.*⁴⁹

12. Sikurse namazi i duhasë, minimumi dy rekatë mund t'i falë te kjo xhami, mirëpo nëse dëshiron më shumë se dy rekate, s'ka problem mund të falë sa të dojë.
13. Kur udhëtari fal namazin farz apo nafle në xhaminë e Kubasë, kjo është e mjaftueshme për ta përshëndetur xhaminë; nuk fal dy rekate të tjera për përshëndetjen e saj.
14. Nuk ka ndonjë vlerë të posaçme vizita e xhamive: mesaxhid es-sebah, mesxhid el-kibletejn, el-gamaameh, el-fet'h, el-ma'ris. Nuk ka ndonjë argument që legjitimon vizitën e xhamive të lartpërmendura, përkundrazi është bidat (risi në fe), nëse njeriu ka bindje që nëpërmjet vizitës së tyre fitohen shpërblime.

⁴⁹ Transmeton Buhariu (1191, 1192).

15. Nuk lejohet t'i jepet porosi udhëtarit që udhëton për Medinë që t'i përshëndesë Profetin (sala Allahu alejhi ue selem) në emër të porosidhënësit, sepse kjo gjë nuk është transmetuar nga shokët e Profetit (sala Allahu alejhi ue selem) e as nga ndonjë prej të parëve tanë të mirë. Është transmetuar që Profeti (sala Allahu alejhi ue selem) ka thënë: *"Dërgoni selam për mua kudo që të jeni, sepse selami juaj arrin tek unë."*⁵⁰ Ibadeti ka nevojë për argument dhe duhet të bëhet në formën që është transmetuar.
16. Jobesimtarit i lejohet hyrja në Medinën e Profetit (sala Allahu alejhi ue selem) dhe qëndrimi në të për në një kohë të shkurtër, ndërsa banimi në të përherë nuk lejohet. Për këtë ka konsensus mes dijetarëve.
17. Nuk lejohet hyrja e jobesimtarit në Xhaminë e Profetit (sala Allahu alejhi ue selem), përveç

⁵⁰ Transmetojnë Ahmedi (8804), Ebu Dauudi (2042), Ibën Haxheri e ka saktësuar në *"Fet'hul bari"* (6/488).

se kur e kërkon nevoja. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam.

Çështje që kanë lidhje me martesën dhe me gruan

1. Nuk i lejohet burrit të udhëtojë për një kohë të gjatë nëse kjo e dëmton gruan e tij, përveç rastit kur gruaja e pranon një gjë të tillë. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam. Burrat të bëjnë kujdes në këtë aspekt dhe të kenë frikë Allahun të mos i dëmtojnë gratë dhe pasardhësit e tyre, sidomos në këtë kohë sprovash.
2. Nuk është kusht që gruaja të marrë lejë nga burri i saj për të udhëtuar për haxh dhe umre (për herën e parë kur e ka për detyrë), sepse bindja ndaj Allahut është më parësore së çdo gjë tjetër. Leja e burrit është kusht për udhëtimet e tjera, të pëlqyera e të lejuara.
3. Ndalohej martesa me qëllim shkurorëzimi (për ta ndarë atë grua, pas një kohe të caktuar apo të pacaktuar), edhe nëse nuk e shfaq këtë qëllim. Kjo lloj martese është e ngjashme me

martesën *el-mut'a*⁵¹ dhe *et-tahlil*,⁵² të cilat janë të ndaluara me konsensusin e dijetarëve.

4. Kur mashkulli është i martuar me më shumë se një grua dhe dëshiron të udhëtojë, jo për shkak të ndonjërës prej grave, atëherë, në këtë rast, i merr të gjitha gratë e tij në udhëtim. Nëse nuk ka mundësi, atëherë hedh short ndërmjet tyre. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam.
5. Nëse shorti i bie ndonjërës prej grave, burri nuk e ka obligim udhëtimin me të. Ai ka të drejtë të udhëtojë i vetëm.
6. Nëse gruaja së cilës i ka rënë shorti refuzon të udhëtojë dhe ia dhuron tjetrës, atëherë kjo lejohet me kusht që burri të jetë i kënaqur. Nëse burri refuzon duke dashur të udhëtojë vetëm më atë që i ka rënë shorti, ajo obligohet t'i binDET burrit: të udhëtojë me të. Ndërsa kur gru-

⁵¹ Martesë me kohëzgjatje të përcaktuar, e cila bëhet sipas marrëveshjes dhe përfundon ashtu si kanë rënë dakord partnerët. (sh.p.)

⁵² Martesë formale, që bëhet me qëllim që gruaja në fjalë të kthehet te burri i parë, pasi është ndarë prej tij përfundimisht. (sh.p.)

aja ia ka vënë kusht burrit të saj në aktin e martesës të drejtën e saj për të mos udhëtuar me të, atëherë lejohet që të mos udhëtojë.

7. Nëse gruaja refuzon të udhëtojë dhe burri respekton zgjedhjen e saj, atëherë përsëritet shorti te të tjerat.
8. Lejohet që burri të përjashtojë ndonjërin prej grave nga shorti për ndonjë arsye të ligjshme, që merret në konsideratë nga sheriati dhe ia zëvendëson asaj me diçka tjetër për të cilën bien dakord të dy.
9. Nëse ka hedhur shortin ndërmjet grave, pasi të kthehet nga udhëtimi nuk ia zëvendëson natën gruas së cilës nuk i ra shorti dhe nuk udhëtoi me të. Në rastin kur nuk ka hedhur short, duhet që t'ia zëvendësojë natën asaj.
10. Mënyra se si ndahen netët me gratë pas kthimit nga udhëtimi
 - a) nëse e ka kryer obligimin e bujtjes tek ajo prej së cilës është larguar për shkak të udhë-

timit - p.sh. nëse ka udhëtuar pas sabahut - atëherë radhën e ka ajo që vjen pas saj;

b) nëse ka udhëtuar në fillim të natës, atëherë kur të kthehet prej udhëtimit, e zëvendëson atë ditë.

11. Nëse udhëton gruaja, pas kthimit nga udhëtimi: a duhet burri t'ia kompensojë natën asaj? Kjo ka disa raste:

a) Nëse ajo udhëton pa lejen e burrit, në këtë rast nuk e meriton që burri t'ia kompensojë natën, ngase konsiderohet rebele duke mos e respektuar burrin e saj.

b) Nëse udhëton me lejen e tij, madje për t'i kryer ndonjë punë apo për nevojat e tij, në këtë rast i takon nata e saj.

c) Nëse udhëton me lejen e tij për nevojat e saj, si p.sh. kryen haxhin, umren etj. në këtë rast asaj nuk i takon nata që ka humbur gjatë udhëtimit, ngase ajo vetë ishte shkaktare.

ç) Nëse burri udhëton së bashku me gruan e tij për ndonjë interes të saj, ajo që kuptohet

prej juristëve islam, për këtë rast, është se asaj nuk i takon nata e saj pas kthimit nga udhëtimi, ngase burri udhëtoi me të dhe për shkak të saj.

12. Nuk lejohet që gruaja të udhëtojë e vetme, pa marrë parasysh a është udhëtimi i gjatë apo i shkurtër, në rrugë tokësore apo ajrore përderisa ai quhet udhëtim tek njerëzit e atij vendi (pra, çështja i adresohet udhëtimit dhe jo mjetit me të cilin kryet ai). Profeti (sala Allahu alejhi ue selem) ka thënë: “*Nuk lejohet të udhëtojë femra vetëm se me mahremin* (kujdestari apo i afërmi) *e saj.*”⁵³ Ndalesa përfshin çdo grua, qoftë e re apo e moshuar. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam.

13. Kushtet që duhet të plotësojë *mahremi* i cili shoqëron femrën në udhëtim: të jetë mashkull në moshën madhore dhe i mençur.

⁵³ Transmetojnë Buhariu (1862) dhe Muslimi (424).

14. Udhëtimi i gruas që është në *idet*.⁵⁴ Ajo mund të përballet me disa situata⁵⁵:

a) Nëse është në *idet* për shkak të vdekjes së burrit të saj, atëherë ka disa dispozita:

- gruaja së cilës i ka vdekur burri nuk lejo-
het të udhëtojë pa ndonjë arsye;
- nëse gruaja udhëton për të kryer haxhin
dhe gjatë rrugës i vdes burri para se të
hyjë në këtë adhurim, në këtë rast ajo du-
het të kthehet, mirëpo nëse ka filluar
kryerjen e haxhit, atëherë e vazhdon rru-
gën për ta plotësuar këtë adhurim; e njëj-
ta gjë thuhet edhe për umren;
- nëse burri i ka vdekur në ndonjë vend
tjetër, kur kanë dalë në udhëtim jashtë
vendit të tyre dhe gruaja frikësohet për
veten e saj, atëherë udhëton te vendi i fa-
miljes së saj dhe e vazhdon *idetin* tek ata;

⁵⁴ Periudhë kohore gjatë së cilës vejushës ose të divorcuarës nuk i lejohej të martohet. (sh.p.)

⁵⁵ Shiko librin tim "*Seluetul fuadi fi adabi ue ahkamil hidad*".

- lejohet që ajo të udhëtojë me familjen e saj për ndonjë nevojë, ndërkohë që qëndrimi i saj e vetme në shtëpi i bën dëm, gjithashtu lejohet të udhëtojë edhe për t'u kuruar;
- nuk lejohet të udhëtojë me familjen e saj për piknik dhe pa pasur nevojë; nëse asnjë nga familjarët e saj nuk pranon që të qëndrojë me të, ajo nuk gjen ndonjë të afërm për ta shoqëruar dhe dëmtohet duke qëndruar vetëm, në këtë rast, asaj i lejohet të udhëtojë me ta, por ky udhëtim duhet të jetë në kufijtë e nevojës, pa e tejkaluar atë;
- nëse shërbëtores i vdes burri, teksa ajo është larg tij në punë, atëherë duhet ta mbajë *idetin* në shtëpinë ku gjendet, ngase është larguar nga shtëpia e saj me lejen e burrit dhe për një kohë të caktuar, prandaj nuk e ka për detyrë të kthehet në shtëpi të burrit që ta mbajë *idetin* aty.

- b) Gruas, që është në *idet* për shkak të shkurorëzimit të përhershëm apo kur ajo vetë ka kërkuar shkurorëzimin (*hul'u* - quhet në arabisht), i lejohet udhëtimi me kusht që të shoqërohet nga i afërmi i saj (mahremi).
- c) Gruas së shkurorëzuar me të drejtë kthimi te burri, nuk i lejohet të dalë nga shtëpia pa lejen e tij, ngase rregulli i marrjes së lejes prej burrit nuk abrogohet, ajo është e njëjtë si para shkurorëzimit.

Nëse është te shtëpia e familjes së saj për shkak të grindjeve e mosmarrëveshjes që ka me burrin e saj dhe e ka të vështirë që t'i kërkojë lejë, duke pasur parasysh se ai mund ta dëmtojë, atëherë, në këtë rast, lejohet të udhëtojë pa lejen e tij.

Disa dispozita rreth çështjeve financiare

1. Për transfertat monetare nga një vend në tjetrin, të shoqëruara me ndryshimin e valutave, ka disa raste:

- a) p.sh. lejohet që rijali i Arabisë Saudite të këmbehet me dinarin, pastaj dinarët dërgohen në një vend tjetër. Gjithashtu lejohet që dinarët të merren në formë çeku apo përmes ndonjë fature arkëtimi, në të cilën shkruhet vlera e parave me valutë në vendit ku dërgohen.
- b) nuk lejohet që rijalët saudian të dorëzohen në ndonjë pikë të këmbimit valutor në Saudi në formë garancie dhe më pas këta të fundit t'i kthejnë rijalët në dinarë pa i marrë klienti që i dorëzoi ato të holla, as drejtpërdrejt, as përmes çekut. Lejohet që pika e këmbimit valutor ta kryejë këtë veprim duke garantuar dorëzimin e dinarëve të përfituesi i tyre në një vend tjetër;

- c) lejohet dërgimi i rijalëve saudian pa i këmbyer ato në ndonjë shtet tjetër, si p.sh. në Egjipt, te përfituesi i tyre, pastaj ky i fundit i këmben rijalët në paundin egjiptian me kursin e këmbimit valutor të asaj dite;
2. Një person i merr borxh dikujt në një valutë të caktuar, pastaj dëshiron që t'ia kthejë borxhin në një valutë tjetër. Ky veprim është i lejuar, por me kushtet e mëposhtme:
- a) të mos jepet i kushtëzuar qysh në fillim, duke e paracaktuar në kontratë që borxhi të kthehet në valutë tjetër;
 - b) të kthehet borxhi me çmimin e ditës së kthimit;
 - c) borxhi të kthehet i plotë dhe jo pjesë-pjesë.

Disa dispozita për ata që qëndrojnë nëpër hotele

1. Sa i përket nënshkrimit të marrëveshjes për qiranë e hotelit pas ezanit të dytë në ditën e xhuma, përgjigja për këtë çështje gjendet te kapitulli "Dispozitat e xhumasë."

2. Ka dy raste në lidhje me gjykimin për marrjen e sendeve të vendosura nëpër dhoma në momentin kur klienti dëshiron të dalë prej hotelit:
 - a) mallrat e konsumit, si p.sh. mjetet e pastri- mit, shapkat, qeset, letrat, lapsat etj. si këto lejohen që të merren, sepse disa hotele i përllogarisin brenda çmimit të paguar për hotelin, kurse disa të tjerë e kanë falas;
 - b) mallra jo të konsumit, si p.sh.: tapetet, pesh- oret, etj. si këto nuk lejohet të merren, sepse nuk llogariten brenda çmimit të paguar për hotelin.
3. Lejohet të hahet çfarë gjendet në bufenë e hap- ur. Nëse dikush thotë se në këtë shitje ka dëm (ngase paguan një çmim, por mund të konsu- mosh ushqim më shumë apo më pak), atëherë përgjigjja është se këtë rast kemi të bëjmë me një dëm të vogël, e tolerueshme, që nuk ka problem dhe raste të tilla të ngjashme ka në shariat.
4. Marrja prej ushqimit të restorantit të hotelit dhe nxjerrja e tij jashtë restorantit pa lejen e përgjegjësit të tij mund të evidentohet si vijon:

- a) marrja e ushqimit të mbetur prej asaj që kanë përgatitur për të ngrënë;
- b) marrja e ushqimit dhe nxjerrja e tij jashtë restorantit, si p.sh. në dhomë apo diku tjetër.

Atëherë a lejohen këto dy raste?

Duhet të shikohet marrëveshja që ka bërë klienti me palën menaxhere të hotelit. Sigurisht që muslimanët duhet t'i përmbushin kushtet për të cilat kanë rënë dakord.

- 5. Nuk lejohet që klienti i hotelit t'u japë ushqim miqve të tij nga bufeja pa paguar apo pa kërkuar leje.
- 6. Lejohet që të marrë ndonjë mysafir në dhomën e tij për të banuar me të përderisa nuk sjell ndonjë dëm, sepse është poseduesi i saj. Mirëpo kur hoteli ia ka kushtëzuar që mos e ndajë dhomën me dikë tjetër, atëherë është e udhës që t'i përmbahet kushtit.
- 7. Mysafirit të klientit në hotel i lejohet të shfrytëzojë vetëm shërbimet që janë për klientin, ndërsa shërbimet e tjera nuk i lejohen, përveçse me leje.

8. Lejohet të përdoret nga të tjerët karta klientit të hotelit që e i merr shërbimet me çmime më të ulëta, nëse ajo jepet falas. Ndërsa kur ajo është me pagesë atëherë nuk lejohet, për t'u ruajtur nga mashtrimi.
9. Nuk lejohet që mashkulli të hyjë në ashensor me një femër të huaj. Lejohet në rastin kur burri hyn së bashku me bashkëshorten e tij dhe në ashensor gjejnë një grua tjetër apo në rastin kur burri hyn i vetëm, ndërkaq atje gjen disa gra.
10. Pastruesit nuk i lejohet të hyjë te dhoma ku gjendet një grua e vetme, sepse veçimi i burrit me një grua të huaj është e ndaluar.
11. Nuk lejohet marrja e ndonjë sendi prej frigoriferit dhe zëvendësimi i tij me ndonjë send të ngjashëm me të, por me çmim më të ulët, vetëm nëse llogaritet diferenca e çmimit.
12. Sa i përket shpërblimit të punëtorëve të hotelit nga ana e klientit, mund të evidentohen dy raste:
 - a) nëse i jep me qëllim që t'i bëjë shërbim të veçantë, si p.sh. t'i jepet ujë apo ndonjë

mjet pastrimi etj. shërbime si këto, më shumë sesa ka rënë dakord me menaxherin hotelit, atëherë, kjo nuk lejohet, sepse është ryshfet;

b) nëse ia jep në formë lëmoshe, sidomos kur largohet nga hoteli, në këtë rast është e lejuar.

13. Nëse në dhomën e hotelit gjenden pije alkoolike dhe administrata e tij pranon që t'i largojë prej dhomës, atëherë klienti obligohet që t'i largojë ato, ngase në këtë mënyrë e largon të keqen. Nëse pija alkoolike është falas, atëherë e derdh atë, me kusht që mos i shkaktojë dëm hotelit.

14. Klientit nuk i lejohet të frekuentojë vendet e ndaluara fetarisht, si p.sh. baret e hoteleve e vende të ngjashme me to.

15. Klienti obligohet t'u përmbahet rregullave dhe kushteve të hotelit përderisa nuk bien ndesh me ligjet e Allahut dhe me marrëveshjen mes tyre.

16. Klienti duhet ta informojnë hotelin nëse dëmtton ndonjë gjë ai vetë apo ata që ka nën kujdestari.
17. Klienti duhet ta kthejë çelësin në momentin e largimit nga hoteli, sepse ai ka vlerë dhe përdoret përsëri, edhe pse rregullat e hoteleve ndryshojnë në lidhje me këtë çështje. Gjithsesi çelësi duhet dorëzuar. Nëse ka harruar që ta kthejë çelësin, atëherë duhet të telefonojë hotelin dhe ta lajmërojë për këtë.
18. Klienti duhet ta informojë hotelin para se të largohet, edhe nëse ka mbaruar koha e qirasë, për të shmangur ndonjë dëm të mundshëm dhe siguruar interesin e dyanshëm.
19. Sa i përket uljes së çmimit dhe favorizimit që hoteli u bën personave juridik, ka dy aspekte:
 - a) nëse personi juridik përfaqëson institucionin e kontrollit dhe inspektimit të hotelit, atëherë nuk lejohet t'i bëhet ky favor, ngase është rryshfet dhe ka dëme të mëdha;
 - b) nëse personi juridik nuk ka kurrfarë përgjegjësie mbi hotelin, atëherë i lejohet që t'i

bëjë ulje çmimi, sepse, në origjinë, transaksionet janë të lejuara.

Disa dispozita që kanë të bëjnë me pakicat e muslimanëve në vendet e joislame⁵⁶

1. Lejohet urimi i jobesimtarit për çështje që kanë të bëjnë jetën e përditshme, si martesë, diplomimi, etj. si këto. Mirëpo nëse jobesimtari është në luftë me muslimanët, atëherë nuk lejohet.

Ndërsa urimi që ka lidhje me simbolet e tyre fetare, në këtë rast nuk lejohet. Gjithashtu nuk lejohet pjesëmarrja në to; për këtë ka konsensus mes dijetarëve.

2. Lejohet që t'i shkohet për vizitë jobesimtarit të sëmurë; nëse ky i fundit është në luftë me muslimanët, atëherë nuk lejohet. Enesi (radi Allahu anhu) thotë: *“Një djalosh hebre, që i*

⁵⁶ Për më shumë, rreth kësaj teme lexo librin tim *“El ibtiaath aamalun ue aalamun ue ahkam”*.

shërbente Profetit (sala Allahu alejhi ue selem), u sëmur dhe Profeti (sala Allahu alejhi ve selem) shkoi që ta vizitonte, iu afrua te koka dhe i tha: “Pranoje Islamin.” Djaloshi shikoi të atin e tij që ishte aty pranë; ai i tha: “Bindu Ebu Kasimit (Profetit - sala Allahu alejhi ue selem).” Djaloshi e pranoi Islamin dhe Profeti doli nga shtëpia e tij duke thënë: “Falënderoj Allahun që e shpëtoi nga Zjarri”.⁵⁷

3. Nuk lejohet që muslimani të varrosë jomuslimanin, përveçse kur nuk ka ndonjë të tillë që ta varrosë atë.
4. Ngushëllimi i jobesimtarit lejohet, sepse nuk ka ndonjë argument që e ndalon këtë. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam. Nëse jobesimtari është prej atyre që janë në luftë me muslimanët, nuk lejohet ta ngushëllojë, vetëm nëse i frikësohet ndonjë dëmi.
5. Jobesimtari mund të ngushëllohet me ndonjë shprehje që shihet si e përshtatshme, që nuk

⁵⁷ Transmeton Buhariu (1356).

përmban ndonjë lutje për shtimin e pasurisë, e pasardhësve, e fuqisë dhe që nuk i kërkohet Allahut falje e mëshirë për të. P.sh. mund t'i thotë “Zoti të dhëntë durim dhe ta lehtësoftë dhembjen” dhe fjalë e të ngjashme me këto.

6. Mbajtja e xhenazes së jobesimtarit dhe transportimi i saj deri te varrezat nuk lejohet, vetëm në rast se kufoma është babai apo ndonjë i afërm i tij dhe mos shoqërimi mund të shkaktojë probleme në familje.
7. Lejohet të vizitohet varri e jobesimtarit, po nuk e përshëndet me selam e as lutet për të.
8. Jobesimtarit nuk i jepet zekati, as kompensimi monetar për zotimin (*nedhrin*), as kompensimi monetar për shlyerjen e fajit (*kefaratu*), ndërsa lëmosha (*sadakaja*) lejohet t'i jepet.
9. Nëse ia ka dhënë zekatin ndonjë njeriu duke menduar që ai është musliman, pastaj bëhet e qartë që personi në fjalë nuk është musliman, duke qenë se për këtë është përpjekur dhe munduar, por ka gabuar, atëherë, në këtë rast, zekati që ka dhënë është i vlefshëm. Mirëpo nëse

nuk është përpjekur dhe munduar, atëherë nuk i pranohet dhe duhet japë përsëri zekatin.

10. Nëse muslimani gjendet në një vend jomusliman ku ka qendra islame që e vrojtojnë me përpikëri hënën për të konfirmuar hyrjen e muajit të Ramazanit, atëherë ai agjëron me njerëzit e atij vendi. Nëse nuk ka përpjekje serioze për vrojtimin e hënës në atë vend, atëherë ai ndjek e pason vendin më të afërt ku ka muslimanë që e vëzhgojnë hënën. E nëse nuk ka ndonjë vend të tillë, atëherë ndjek e pason vendin më të afërt islam.
11. Si agjërohet në vendet ku zgjat shumë dita apo nata? Nëse në ato vende dita e nata janë të dallueshme (ndonëse zgjat shumë ndonjëra prej të dyjave), atëherë muslimani obligohet të agjërojë përderisa ka ditë dhe natë. E nëse dita dhe nata nuk dallohen, siç ndodh në disa vende ku disa muaj është vetëm ditë e disa muaj vetëm natë, atëherë, në këtë rast, shikohet vendi më i afërt ku ka ditë dhe natë dhe agjërojnë në kohën kur agjërojnë këta të fundit.

12. Lejohet të vizitohet jobesimtari në shtëpinë e tij, nëse ka siguri se nuk provokohet ose përballat me ndonjë haram. Madje, është e pëlqyer që të vizitohet jobesimtari, nëse shpresohet që ai të pranojë Islamin.
13. Lejohet shkëmbimi i dhuratave mes muslimanëve dhe jomuslimanëve në raste të përgjithshme, si p.sh. në rast diplomimi, në gëzime familjare siç është lindja e fëmijës e kështu me radhë. Mirëpo nuk lejohet të pranohet dhuratat e tyre, nëse pranimi përmban gjëra të ndaluara. Sikurse nuk lejohet t'u jepen dhurata për festat e tyre, ndërkaq pranohet dhurata e tyre për festat tona, nëse ato nuk përmbajnë gjëra të ndaluara.
14. Nuk lejohet ta hahet mishi i dhuruar nga jomuslimanët, kur ata therin kafshë posaçërisht për festat e tyre.
15. Nuk lejohet pjesëmarrja në tubimet e jomuslimanëve ku ka gjëra të ndaluara. Lejohet vetëm

në rast nevojë apo nga frika e dëmtimit prej tyre.

16. Kur jomuslimani teshtin mund t'i thuash: "Jehdikumull-llahu ve juslih balekum - Allahu ju udhëzofte dhe jua përmirësofte gjendjen tuaj." Ebu Musa tregon: "Hebrenjtë teshtinin në prezencë të Profetit (sala Allahu alejhi ue selem) duke shpresuar që ai (sala Allahu alejhi ue selem t'u thoshte "Jerhamukumull-llah (Allahu ju mëshirofte), mirëpo Profeti (sala Allahu alejhi ue selem) u thoshte: "*Jehdikumull-llahu ue juslih balekum.*"⁵⁸

17. Nuk lejohet që muslimani ta përshëndesë me selam i pari jomuslimanin, ndërsa përshëndetja duke i thënë p.sh. "*mirëmëngjesi*" apo diçka e ngjashme me të lejohet. Nëse ata japin selam, atëherë u thuhet: "*Ue alejkum* (edhe juve)".

⁵⁸ Transmetojnë Ahmedi (19586), Tirmidhiu (2739) dhe e ka konsideruar të vërtetë, po ashtu Neueuii e ka saktësuar në librin e tij "*El-edhkar*" (344).

18. Lejohet që jobesimtari të përshëndetet duke ia shtrënguar dorën dhe është më mirë të mos përqafohet, sepse përqarimi është shenjë e shprehjes së kënaqësisë dhe dashurisë.
19. Sa i përket dispozitave të ngrënies së ushqimit që vjen prej vendeve jomuslimane mund të thuhet si vijon:
 - a) Ushqimet bimore, si frutat dhe perimet, apo prodhimet bujqësore, si gruri etj. Lejohen.
 - b) Të gjitha llojet e ushqimit të detit lejohen në përgjithësi.
 - c) Sa i përket mishit të kafshëve evidentohen disa raste:
 - Nuk lejohet konsumimi i mishit të kafshëve që nuk janë therur nga ithtarët e Librit, si zjarrputistët, politeistët, hindusët, ateistët etj., edhe nëse ata e përmendin emrin e Allahut gjatë flijimit të kafshëve dhe i therin ato sipas mënyrës islame. Për këtë ka konsensus mes dijetarëve.
 - Ka disa raste për sa i përket mishit që vjen prej ithtarëve të Librit:

- Nëse sigurohemi që është përmendur emri i Allahut dhe është therur në mënyrën e ligjëruar nga sheriati, atëherë lejohet ngrënia e mishit të tyre.
- Nëse sigurohemi se kafsha nuk është e therur sipas mënyrës së ligjëruar nga sheriati, ose nuk është përmendur emri i Allahut gjatë therjes, atëherë nuk lejohet ngrënia e mishit. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam.
- Nëse nuk dihet e sigurt se a është përmendur emri i Allahut dhe a është therur në mënyrën e ligjëruar nga sheriati, atëherë nuk lejohet të hahet mishi që vjen prej tyre, sepse, në përgjithësi dhe më e sigurta është që ata nuk e therin kafshën sipas mënyrës së ligjëruar nga sheriati.
- Nëse dihet se është kafsha është therur sipas normave të shariatit, por nuk është përmendur as emri i Allahut gjatë therjes dhe as ndonjë emër tjetër,

edhe në këtë rast nuk lejohet të hahet pasi përmendja e emrit të Allahut gjatë therjes është kusht.

- Ndalohen të konsumohet mishi që vjen prej ndonjë popull jomusliman, që nuk dihet me siguri se është apo jo prej ithtarëve të Librit.

20. Lejohet ngrënia në enët e jomuslimanëve, nëse dihet që ato nuk janë përdorur për të mbajtur apo gatuar ushqime apo pije të ndaluara e të papastra. Mirëpo, nëse dihet apo anojmë në mendimin që ato enë janë përdorur për gjëra të ndaluara e të pista, ndërkohë nuk gjejmë të tjera, atëherë patjetër duhet të lahen dhe pastaj të përdoren. Nëse gjenden të tjera enë përveç tyre, atëherë më e mira është që të mos përdoren.

21. Nuk lejohet ngrënia në restorantet e jomuslimanëve ku gjenden ushqime e pije të ndaluara si mishi i derrit, alkooli etj. Mirëpo në rast nevojë lejohet, me kusht që të mos ulet në tavolinën ku ka pije alkoolike.

22. Lejohet urinimi në këmbë në tualetet e tyre ku urinohet në këmbë, me kusht që të mos ndoten rrobat nga papastërtitë.
23. Rrobat muslimanit mund të lahen së bashku me rrobat e jomuslimanit.
24. Lejohet përdorimi i rrobave të jomuslimanëve para larjes, nëse ato janë prej rrobave që nuk prekin organet gjenitale, si p.sh. këmisha etj. Mirëpo nëse prekin organet gjenitale, si p.sh. pizhamet etj. më e mira është të mos vishen, ndërsa pasi të lahen, lejohet që të vishen.
25. Sa i përket dhënies së mus'hafit (Kuranit) jomuslimanëve evidentohen dy raste:
 - a) Nëse Kurani është në gjuhën arabe, nuk lejohet, sepse jomuslimani mund të jetë i papastër dhe mund ta përdhosë atë.
 - b) Nëse Kurani është i përkthyer dhe shpresohet që do ta pranojë Islamin, atëherë lejohet.

Çështje që kanë të bëjnë me kthimin nga udhëtimi

1. Është e pëlqyer që udhëtari pasi të ketë kryer punët të shpejtojë për t'u kthyer te familja e tij.
2. Është e pëlqyer që udhëtari pasi të kthehet në vendin e vet, të falë dy rekate në xhami. Nëse i gjen xhamitë të mbyllura, atëherë i fal në shtëpi. Lejohet që këto dy rekate të falen në kohën kur namazi vullnetar është i ndaluar, sepse ato kanë një shkak që i legjitimon. A është mirë që dhe gruaja t'i falë këto dy rekate? Kjo çështje është e diskutueshme. Gjithsesi asaj i lejohet që t'i falë këto dy rekate.
3. Profeti (sala Allahu alejhi ue selem) e ka ndaluar që burri të kthehet te familja e tij natën,⁵⁹ pasi të ketë munguar një kohë të gjatë. Mirëpo nëse i lajmëron familjarët që është duke ardhur, atëherë, në këtë rast, lejohet.
4. Kur njeriu kthehet prej udhëtimit, është e pëlqyer që vëllezërit e tij t'i shkojnë për vizitë dhe

⁵⁹ Transmetojnë Buhariu (1800) dhe Muslimi (1928).

ta përshëndesin. Ndërsa kur dëshiron të udhëtojë, ai shkon tek ata për t'i përshëndetur dhe për të përfituar prej lutjeve të tyre.

5. Kur udhëtari kthehet prej udhëtimit, është e pëlqyer që të pritët në këmbë dhe të përqafohet.
6. Kur udhëtari kthehet prej udhëtimit, është e pëlqyer që të pritët me gosti apo ai vetë ta organizojë një gjë të tillë.

Duke ecur në rrugën e thirrjes islame⁶⁰

Thirrësi ka merak dhe ndien përgjegjësi për thirrjen në fenë e Allahut dhe mësimin e njerëzve, qoftë në vendin e tij apo në udhëtim, sepse daveti (thirrja islame) për të është si ushqimi, uji, pija, ajri dhe jeta, mishi, gjaku dhe eshtrat. Kështu që ai duhet t'i kushtojë rëndësi të madhe hartimit të programeve mësimore, edukative e predikues dhe zbatimin e tyre në praktikë. Në këtë kontekst mund të përmendim si vijon:

⁶⁰ Për më shumë, lexo librin tim "*Fethul afak lil amelil xhaad*".

- a) Udhëtarëve t'u jepen libra, fletëpalosje dhe incizime të ndryshme të dijetarëve të besueshëm që t'i shpërndajnë apo t'i vendosin në xhamitë buzë rrugës, në aeroporte etj.
- b) Hartimi i programeve të dobishme në udhëtim. Këto programe mund të përmbajnë ligjëratat, konkurse dhe mësim përmendësh të disa sureve, haditheve dhe lutjeve.
- c) Udhëtimi është një rast i mirë për thirrjen në fenë e Allahut, për mësimin e njerëzve dhe për edukimin e fëmijëve duke qëndruar me ta një kohë më të gjatë.
- ç) Vizita e shokëve, miqve dhe e të afërmeve të farëfisit, ruajtja e forcimi i lidhjeve të gjakut është prej punëve më të mira.
- d) Pjesë e programeve të udhëtimit duhet të jetë edhe vizita e nxënësve të dijes, thirrësve, organizatave të thirrjes dhe atyre humanitare, që të përfitohet prej tyre dhe të këshillohen për punë të mira.

- e) Udhëtari para se të udhëtojë duhet të pajiset me disa libra që i duhen gjatë rrugës dhe në udhëtim të vizitojë libraritë.

Në fund, e lusim Allahun të na dhurojë dije të dobishme, të na mundësojë kryerjen e veprave të mira, të na japë bereqet në punët tona, në jetën tonë, në gratë tona e pasardhësit tanë, të na pastr-ojë dhe dëlirësojë zemrat dhe shpirtrat tanë. E lusim Allahun ta ndihmojë dhe ta ruajë Islamin dhe muslimanët.

Shkroi: Fehd ibn Jahja El-Amari

Botimi i katërt, viti 1438 h.

famary1@gmail.com

Meka e Shenjtë

Përmbajtja

Parathënie	5
Dobitë e udhëtimit	10
Dispozitat e udhëtimit	13
Parametrat dhe kriteret që duhet të plotësohen në një udhëtim, në mënyrë që të lejohen lehtësimet fetare dhe të trajtohen çështje të tjera që kanë të bëjnë me të .	13
Kur e ku fillon aplikimi i dispozitave të udhëtimit?	17
Kategoritë e njerëzve në raport me vendqëndrimin e përhershëm, me qëndrimin e përkohshëm dhe me udhëtimin	22
Disa rregulla etike	31
Kërkimi i lejes nga prindërit për të udhëtuar	31
Dobi:	35
Disa këshilla prej të parëve tanë të devotshëm për udhëtarët.....	40
Përzgjedhja e <i>emirit</i> (prijësit) në udhëtim dhe çështjet që ndërlidhen me të	44
Lutja profetike gjatë udhëtimit.....	46
Çaste meditimi.....	50
Vërejtje dhe paralajmërim!	53
Çfarë është thënë për udhëtimin?	53

Çështje që i përkasin sferës së besimit	54
Vërejtje!	57
Dispozitat e pastërtisë	59
Dispozitat e ezanit	64
Dispozitat për namazin	66
Dispozitat e imamit nga vendasi për udhëtarin dhe e kundërta	82
Dispozitat e bashkimit të namazeve	90
Momente nga jeta e dijetarëve (Allahu i mëshiroftë) si e shfrytëzonin ata kohën gjatë udhëtimeve.....	100
Bamirësit në udhëtimet e tyre	101
Dispozitat e ditës së xhuma	102
Dispozitat e Bajramit	109
Dispozitat e zekatit	110
Dispozitat e agjërimit	111
Disa dispozita rreth vizitës së Mekës dhe Qabesë së Shenjtë	119
Disa dispozita të haxhit dhe të umres.....	121
Dispozitat e vizitës së Xhamisë së Profetit (sala Allahu alejhi ue selem)	127
Çështje që kanë lidhje me martesën dhe me gruan	135
Disa dispozita rreth çështjeve financiare	142
Disa dispozita për ata që qëndrojnë nëpër hotele	144

Disa dispozita që kanë të bëjnë me pakicat e muslimanëve në vendet e joislame.....	150
Çështje që kanë të bëjnë me kthimin nga udhëtimi.	160
Duke ecur në rrugën e thirrjes islame.....	161
Përmbajtja	165

Titulli i originalit

زاد المسافر

تأليف

فهد بن يحيى العمري

Përktheu:

Sefedin MEHANI

Arsim GASHI

Redaktor fetar

Mr. Xheladin LEKA

Redaktor letrar:

Mr. Arjan KOÇI

Përgatiti për shtyp:

Bashkim AVDIU

Shtypi:

Focus Print

Shkup-Prishtinë

Botues:

ESSEBIL

Gjilan 2018